



Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti : Shkencat Shoqërore Bashkëkohore

Drejtimi : Diplomaci

STUDIMET POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

Teza :

Roli i Presidentit të shtetit në procesin e politikbërjes (Maqedoni, Kosovë, Shqipëri)

Kandidati :

Majlind Mustafa

Mentori :

Prof.Dr. Jonuz Abdullai

Shkurtesat :

PËRMBAJTJA :

- i. Hyrje
- ii. Përmbajtja e studimit
- iii. Metodologjia e studimit

KAPITULLI I

- 1. Aspektet teorike mbi Presidentin e shtetit
 - 1.1 Shtjellime të përgjithshme mbi Presidentin e shtetit
 - 1.2 Presidenti i shtetit në procesin e vendimmarrjes politike
 - 1.3 Roli i Presidentit të shtetit në sistemet qeverisëse

KAPITULLI II

- 2. Roli i Presidentit të shtetit sipas kushtetutës (Maqedonia e Veriut, Shqipëri, Kosovë)
 - 2.1 Zgjedhjet e para Presidenciale në shtetin e pavarur të Maqedonisë së Veriut.
 - 2.2 Zgjedhja e Presidentit
 - 2.3 Kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
 - 2.4 Përgjegjësia e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
 - 2.5 Pozita e kreut të shtetit

3. Roli i Presidentit të shtetit të republikës së Shqipërisë

3.1 Fillet e pluralizmit politik dhe zgjedhjet e para Presidenciale

3.2 Zgjedhja dhe mandati i Presidentit të Republikës së Shqipërisë

3.3 Kompetencat e Presidentit në raport me institucionet tjera

3.4 Roli i Presidentit në papërgjeshmërinë politike

4. Roli i Presidentit të shtetit të Republikës së Kosovës

4.1 Një historik i Presidentit të Kosovës

4.2 Roli i Presidentit sipas kompetencave

4.3 Modeli i zgjedhjes së Presidentit

Kapitulli III

5. Dallimet në mes normative dhe reales në funksionimin e Presidentit të shtetit (Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova)

5.1 Roli i Presidentit të Maqedonisë së Veriut

5.2. Presidenti i Maqedonisë së Veriut në politikën e jashtme

5.3 Presidenti i Republikës në raport me institucionet tjera

6.1 Presidenti i Republikës së Shqipërisë

6.2 Presidenti i Shqipërisë në politikbërjen e jashtme

6.3 Roli i Presidentit të Shqipërisë në luftën e Kosovës

7.1 Presidenti i Kosovës si përfaqësues unitetit të popullit

7.2. Presidenti i Kosovës në sferën e politikës së jashtme

7.3 Roli i Presidentit Ibrahim Rugova në procesin e politikbërjes

HYRJE

Presidenti i shtetit në vendet e rajonit tonë, ka pasur ndikime të rëndësishme jo vetëm në aspektin e kompetencave të tij si President, por edhe në aspektin e ruajtjes së imazhit shtetëror, duke bërë përpjekje që përveç se të jetë i paanshëm në aspektin politik (që e ka edhe detyrë ligjore) por edhe të kontriboj në mënyrë të drejte, që të garantoj stabilitet politik në raste kur krijohen ngërçe politike. Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria janë vende të cilat kanë kaluar nëpër shumë faza të ndryshme politike, dhe nëpër shumë kriza institucionale dhe transformime të ndryshme shtetërore, kjo e bën që në situata delikate, të ketë ndërhyrje nga Presidenti i shtetit për të zgjidhur situatat politike dhe jo vetëm. Por në situata tjera ka ndodhur që edhe vetë Presidenti të krijoj situata jo të duhura, duke sjellur përplasje mes qeverisë, parlamentit, por edhe revoltimin e popullit. Politika e jashtme e vendit ka një rëndësi të veçantë dhe sidomos tani që vendet aspirojnë, futjen në Bashkimin Evropian, por edhe krijimin e një paraqitje të jashtme sa më efikase, edhe këtu Presidenti i shtetit luan rol shumë të madh, duke qenë se jo vetëm në disa pika kushtetuese ai ka obligime dhe detyra në politikën e jashtme, por edhe duke qenë person që zhvillon takime jashtë vendit, por edhe brenda saj, ai jep mesazhe që kanë një rëndësi të madhe në mënyrën sesi ai ruan imazhin e vendit dhe në mënyrën e përfaqësimit të tij për të bërë paraqitje sa më të mire. Prandaj në këtë punim do të shtjelloj, jo vetëm kompetencat e Presidentit të

shteteve që i kam marrë si raste studimi, por edhe mënyrën sesi ato kanë zhvilluar proceset e politikbërjes shtetërore, mënyrën e zgjidhjes së problemeve. Poashtu një nga kapitujt e kam edhe rolin e Presidentit Amerikan, duke bërë një komparacion mes tre shteteve (Maqedoni, Kosovë, Shqipëri) dhe atij Amerikan, duke bërë dallimet e Presidentëve dhe ngjashmërit e tyre.

KAPITULLI I: Aspektet teorike mbi Presidentin e shtetit

1.1 Shtjellime të përgjithshme mbi Presidentin e shtetit.

Shefi i shtetit, kreu i shtetit, kryetari ose Presidenti, teoria dhe praktika kushtetuese e njohin me emërtime të ndryshme kur bëhet fjalë për Presidentin. Nga sqarimet në fjalorët juridik gjejmë që President në fakt është titulli më i lartë që i jepet një personi dhe që ka pozicionin më të lartë politik, i cili në disa vende mund të jetë edhe Shefi i Qeverisë. Përveç kësaj në anën tjetër, emërtimi i shefit të shtetit është i dallueshëm nga kreu i Qeverisë dhe tregon titullarin ose të parin e shtetit, që mund të jetë Mbreti ose Presidenti. Pothuajse të njëjtin kuptim sikurse emërtimi shef i shtetit e ka edhe emërtimi kreu i shtetit, në fakt edhe ky emërtim nënkupton liderin e një vendi, Mbretin, Mbretëreshën ose Presidentin. Kështu në disa vende Presidenti paraqitet si mbret ose monark, kurse në shumicën prej vendeve si i zgjedhur, respektivisht si President kushtetues. Figura kushtetuese e Presidentit të sotëm është figura e monarkut të transformuar përgjat historisë.¹ Shefi i shtetit, si organ shtetëror është paraqitur para parlamentit dhe, në kohën e monarkisë absolute, i ushtronte të gjitha funksionet shtetërore. Përgjat sundimit me shtetin, monarku absolut ndihmohej nga rrethi i ngushtë i njerëzve që gëzonin besimin e plotë të tij, e që më vonë prej tyre do të formësohet qeveria. Në kohën kur erdhi deri te ndarja e funksioneve shtetërore, shefi i shtetit bëhet bartës i funksionit ekzekutiv, me atë që vetëm në sistemet presidenciale, shefi i shtetit bëhet bartës i tërë pushtetit ekzekutiv kurse, në sistemet me ndarje fleksibile të pushtetit, pushtetin ekzekutiv e ushtrojnë dy organe (shefi i shtetit dhe qeveria). Shefi i shtetit paraqitet në dy forma, edhe atë si : organ individual (kur këtë funksion e ushtron një individ, me ç'rast ai paraqitet si : monark, kryetar i republikës dhe kryetar i shtetit, që mbizotëron në pjesën dërmuese të shteteve në botë) dhe si *organ kolegjal* (kolektiv, tupor) kur këtë funksion e ushtrojnë dy e më tepër persona, si për shembull, në Zvicër, Uruguaj ish – shtetet socialiste, etj. Kur flitet për *shefin individual të shtetit në shtetet jomonarkiste*, duhet nënvizuar faktin se , *kryetari i republikës* dhe *kryetari i shtetit* nuk mund të njëjtësohen si

¹ Bajrami Arsim, Muçaj Florent "E drejta kushtetuese" Prishtinë 2018, fq 381

kategori të njejta kushtetuese, sepse *kryetari i republikës* është shef i shtetit në kuptimin e rëndomtë të shefit të shtetit si kategori kushtetuese, ndërkaq, *kryetari i shtetit* është në radhë të parë, shef faktik i pushtetit ekzekutiv si dhe shef i shtetit.² Në shumicën dërmuese të shteteve bashkëkohore **shefi i shtetit është kryetari i zgjedhur**. Është i zgjedhur në zgjedhjet e drejtpërdrejta apo në parlament sipas procedurës së posaçme, me shumicën e kualifikuar apo në mënyrë të ngjashme.³

1.2 Presidenti i shtetit në procesin e vendimmarrjes politike

Vendimmarrja është një proces drejtues në të cilën përshtatjet bëhen si rrjedhojë e fitbekut prej botës së jashtme. Vendimet zbatohen me anën e veprimeve që ndërmerren për të ndryshuar realitetin e më pas informacioni i marrë prej realitetit vëzhgohet për të vlerësuar rrjedhojat e veprimeve. Këto vlerësime, bashkë me informacionin për ndryshime të tjera të pavarura në mjedis – futen në procesin e vendimmarrjeve të tjera. Ky proces drejtues me fitbek të jashtëm mbështetet në qëllimet e vendimmarrësit ose atë çka ajo ose ai janë duke u përpjekur të arrijnë. Gjatë rrugës për të arritur drejt këtyre qëllimeve, vendimmarrësit vendosin objektiva që janë hapa të kujdesshme për t'u bërë. Objektivat ndryshojnë brenda një hapësire, e cila përfshin si objektivat thelbësorë afatgjatë, edhe objektivat shumë afatshkurtër, praktikë.⁴

Historia është e mbushur me shembuj ku është shfaqur dukshëm rëndësia themelore e liderëve politik, të cilët në kohë, hapsira dhe rrethana të ndryshme kanë luajtur një rol jashtëzakonshëm në formësimin e histories botërore. Mikhail Gorbaçov⁵ shfaqti një aftësi të jashtëzakonshme individuale, duke ndryshuar rrjedhën e historisë. Shumë ekspertë besojnë që Lufta e Ftohtë nuk do të kishte një fund dhe as fuqia e rregullave të Partisë Komuniste në Moskë nuk do të përfundonte si dhe Shteti Sovjetik nuk do t'i hapte rrugë demokracisë dhe sipërmarrjes së lirë, po

² Shasivari Jeton "E drejta kushtetuese" Furkan Ism, Shkup 2015, fq 356

³ Petriç Ernest "Politika e Jashtme", Kolegji Universitar Victory, Prishtinë 2012, fq 337

⁴ Goldstein S. Joshua "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", Dituria, 2003, fq,167.

⁵ Mikhail Gorbaçov, si udhëqës solli dy koncepte politike për përmirësimin e vendit "Glastnost" (transparence, hapje) dhe " Prestroika" (rikonstruim) . Politika e tij e jashtme solli ndryshime përmirësoi raportet me perëndimin, përfshirë këtu Gjermaninë dhe Amerikën, ishte lideri që i dha fund Luftës së Ftohtë dhe me të edhe u shpërbë Bashkimi Sovjetik. Për më tepër shih : "Fjalimet që ndryshuan botën" IDK, 2016 (Tiranë) fq, 242

të mos kishte qenë vizioni i Gorbaçovit, kuraja dhe zotimi i tij për të aplikuar këtë sistem transformues dhe revolucionar.⁶

Zgjedhja mund të ndërlikohet nga pasiguria për koston e përfitimet e veprimeve të ndryshme. Në të tilla raste, vendimmarrësit duhet të parashikojnë probabilitetin për secilin prej përfundimeve të mundshme të një veprimi. Disa vendimmarrës e pranojnë rrezikun deri diku, ndërsa të tjerët nuk e pëlqejnë rrezikun. Këta faktorë ndikojnë mbi rëndësinë që vendimmarrësit u kushtojnë përfundimeve të ndryshme alternative që mund të rrjedhin prej një veprimi. Për shembull, veprimi i Sadam Huseinit për të sulmuar Kuvajtin tregoi për pranim të lartë të shkallës së rrezikut. Përfitimet e mundshme ishin të mëdha (futja në dorë e pasurive të Kuvajtit për të zgjidhur problemet ekonomike të Irakut)⁷ Liderët, gjithashtu, mund të ndërmarrin një rrezik më të madh për të mbrojtur atë çfarë e kanë – ‘‘efekti i ndihmës’’ – sesa rrisin fitoret e tyre. Ata gjithashtu, mund të ndërmarrin një rrezik më të madh për të ndryshuar humbjet, për të rrimarë atë çfarë kishin dikur, sesa për atë çka do të bënin për të arritur fitore të reja. Kur vendimmarrësit pësojnë një humbje të madhe, ata janë shumë më pak të predispozuar për t’u pajtuar me të, sesa ishin për të rrahur gjoksin për fitoret. Se fundi, liderët i ndërrojnë preferencat e tyre dhe bëjnë zgjedhje të ndryshme, kur problemet trajtohen më tepër si humbje se si fitore. Këto përfundime të përgjithshme zbatohen drejtpërdrejtë në zgjedhjen e politikës së jashtme. Për shembull, Sadat⁸, presidenti i Egjiptit, asnjëherë nuk u ‘‘qetësua’’ për humbjen e gadishullit të Sinaït në luftën me Izraelin, në vitin 1967. Megjithëse Izraeli kishte një avantazh të dukshëm në kapacitetet ushtarake, Sadat-i ishte i papërmbytur dhe mjaft i motivuar për të rimarrë Sinain. Ai bëri një skemë të forcave ushtarake të Izraelit dhe filloi luftën kundër saj në vitin 1973.⁹ Mirëpo në nëntor bota mbajti frymën kur me një vizitë të papritur dhe me një lëvizje të pashembullt

⁶ Charles W. Kegley, Jr, ‘‘Politikat botërore tendenca dhe transformimi’’, UFO Press, Tiranë 2009, fq, 71

⁷ Goldstein S. Joshua ‘‘Marrëdhëniet Ndërkombëtare’’, Dituria, 2003, fq, 168

⁸ Karriera politike e Sadatit mori një kthesë të re pas vdekjes së Naserit në 1970. Ai poashtu mori vendime afatgjata në politikën e jashtme. Sadati besonte se konflikti arabo – izraelit dhe ankesat palestineze që gjendeshin në bazën e saj mund të zgjidheshin më lehtë duke u mbështetur tek ndihma Amerikane sesa tek ndihma Sovjetike. Në mes të luftës 1973, ku Egjipti sulmoi izraelin Sadati u bëri thirrje izraelitëve që t’i lëshonin tokat e pushtuara arabe në vitin 1967 duke përfshirë edhe gadishullin e Sinaït që gjendet ne Egjipt, dhe poashtu të jenë të drejtë ndaj kërkesave palestineze. Për këtë më tepër shih : ‘‘Mendimi politik dhe shoqërore mbi Lindjen e Mesme bashkëkohore’’ botim i rishikuar dhe zgjeruar, redaktuar nga Kemal H. Karpat, ALSAR, 2018, Tiranë, fq, 251,254

⁹ Smith Steve, Hadfield Amelia, Dunne Tim, ‘‘Politika e jashtme, teori, aktorë, raste’’ UET press 2012, fq, 170-171

Sadati vizitoi shtetin hebre ¹⁰dhe foli në parlamentin Hebre. Megjithëse as Sadati dhe as Begin nuk bënë lëshime gjatë takimeve të para në Jerusalem të dy udhëheqësit bënë një premtim solemn për të mos luftuar asnjëherë njeri me tjetrin.¹¹ Çdo ngjarje ndërkombëtare është rrjedhoja e synuar ose e pasynuar e vendimeve të marra nga individë. MN jo vetëm ndodhin. President Herri Trauman, i cili mori vendimin për të hedhur bombat bërthamore mbi dy qytetet japoneze ¹²në vitin 1945, e kishte kuptuar këtë . Ai kishte nje shenjë mbi tryezën e tij të punës : ‘‘Përgjegjësia mbetet këtu’’ . Si udhëheqës i fuqisë më të madhe të botës, ai nuk kishte kujt t’ia shkarkonte përgjegjësinë. Në qoftë se ai do të zgjidhte përdorimin e bombës (siç bëri), do të vdisnin më se 100 mijë qytetarë. Në qoftë se ai do të zgjidhte mospërdorimin e saj, lufta mund të zvarritej për disa muaj e do të shkaktonte dhjetëra mijë viktima për SHBA-në. Traumani duhej të zgjidhte. Disa njerëz përshëndetën vendimin e tij ; të tjerët dënuan atë.¹³

¹⁰ Në këtë vizitë u angazhua shumë edhe ish –Presidenti Amerikan Jimmy Carter, i cili më pas i ftoi edhe në Camp David, edhe ku u arrit marrëveshja (atëbotë) historike mes një konflikti 30 vjeçar arabo –izrelit, dhe egjiptit ju rikthye gadishulli i Sinait, e cila ishte ndër shkaqet kryesore të konfliktit disavjeçar, dhe poashtu një vendimmarje e guximshme dhe e papritur e presidentit të Egjiptit Naser që finalizoj këtë marrëveshje. Lexo më shumë : Louise Fawcett, “Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme” UET Press, Tiranë, 2009, fq 228-229

¹¹ John G. Stoessinger “Përse kombet shkojnë në luftë” Instituti i Studimeve Ndërkombëtare ,botimi i dytë, Tiranë, 2009,fq 243 – 244.

¹² Sulmi nuklear mbi dy qytetet japoneze, Hiroshima dhe Nagasaki ishte një vendim tepër i madh, e cila solli pasoja shumë të mëdha si në aspektin material edhe në atë fizik, duke u futurë kështu në proven e parë bërthamore, shih më tepër, John Baylis, James J. Wirtz, Colin S. Gray, Eliot Cohen “Strategjia në botën bashkëkohore”, UET PRESS, 2013, Tiranë, fq 253.

¹³ Goldstein S. Joshua “Marrëdhëniet Ndërkombëtare” Dituria, 2003, fq 170

1.3 Roli i Presidentit të shtetit në sistemet qeverisëse

Roli dhe funksionet e kreut të shtetit lidhen me tipin e formës së të qeverisurit , përvojës historike dhe traditave politiko administrative të një vendi, si dhe detyrimeve që ka një vend në kuadër të pjesmarrjes dhe bashkëpunimeve që ai ka në organizma mbinacionale dhe rajonal. Në sistemet parlamentare kreu i shtetit mund të jetë vetëm shef zyrtar ekzekutiv i shtetit, duke poseduar fuqi ekzekutive, si për shembull në Mbretërinë e Bashkuar ku qeveria vepron në emër të mbretëreshës jo parlamentit. Në realitet për shkak të evolucionit kushtetues, fuqitë ushtrohen nga një kabinet, kryesuar nga një kryeministër i cili përgjigjet para parlamentit. Disa sisteme presidenciale mund të përfshijnë një kryeministër dhe ministrant të jenë përgjegjës tek presidenti dhe jo ndaj legjislaturës . Një Kryeministër në një sistem presidencial ka mungesën e domanincës kushtetuese dhe politike të një kryeministri në një sistem parlamentar. Sistemet gjysëm presidenciale kombinojnë karakteristikat e sistemeve presidencial dhe parlamentar, ku qeveria përgjigjet tek presidenti dhe legjislatura.¹⁴ Në sistemet evropiane presidenciale, në Francë dhe në Rusi kemi të bëjmë me **sistem hibrid ndërmjet sistemit parlamentar dhe presidencial**. Në sistemet presidenciale i klasifikojmë për faktin se kryetarët kanë rol vendimtar pikërisht në çështjet e politikës së jashtme në të dy rastet. Dallimi më i rëndësishëm ndërmjet sistemit presidencial amerikan dhe sistemit në Francë dhe Rusi qëndron aty , se në Francë dhe në Rusi¹⁵ përpos kryetarit të shtetit ekziston edhe qeveria me kryetarin e qeverisë dhe me ministrin e jashtëm, që formalisht i përgjigjen parlamentit dhe varen nga mbështetja, gjegjësisht nga raporti i fjavave politike në parlament. Nëse e ka shumicën në parlament, opsioni politik të cilit nuk i takon kryetari dhe për këtë arsye qeveria dhe kryetari i saj politikisht nuk janë nga një opsion politik si kryetari, shefi i shtetit mund të vijë në problem gjatë përcaktimit dhe zbatimit të politikës së jashtme. Kjo ka ndodhur në praktikë disa here në rastin e Francës. Kompetencat e

¹⁴ Kelmendi Salih "Qeverisja dhe politika si ndërvarësi, koncepte ,parime, praktika" "UET press" Tiranë 2015, fq , 104

¹⁵ Në Rusinë postkomuniste, duke qenë se parlamenti u vu gjithnjë e më shumë në kontrollin e atyre që mbanin linjën e ashpër, dhe që poashtu kërkonin ti rezistonin paketës së "terapisë së shokut" . Në fund presidenca e Jelcinit mbizotëroi vetëm përshkak të mbështetjes së ushtrisë që e shpartalloi rebelimin e parlamentit në tetor të vitit 1993, që edhe dërgoj edhe në vendosjen e sundimit Presidential. Megjithatë tradita e rusisë për udhëheqje të fort ekzekutive u rivendos që prej vitit 2000 nga Presidenti Putin. Presidenti Putin vendosi një presidencë hegjemone, të bazuar në atë që ai e quan "diktatura e ligjit" të fuqizuar nga popullariteti që mori duke bërë luftë kundër Çeçenisë dhe duke i rezistuar seperatizmit rajonal., më shumë shih : Andrew Heywood "Politika" Dudaj Tiranë,2008, fq 363

politikës së jashtme si të kryetarit francez ashtu edhe të atij rus, si dhe roli i tij faktik në politikën e jashtme është i tillë që mund ta klasifikojmë në sisteme presidenciale. Kjo vlen në veçanti për periudhën e Kryetarëve Miterran të Chiraq, e posaçërisht De Golli-t¹⁶ dhe Giskard D' Estaing, ndërsa në Rusi Putinit.¹⁷ Shefi i shtetit, kryetari edhe në sistemin parlamentar pak a shumë ndikon në politikën e jashtme, në mënyre formale dhe jo formale, varësisht nga mbështetja politike dhe nga autoriteti që ka, por edhe nga interesi dhe angazhimi i tij në politikën e jashtme. Me ndihmën e kontakteve që ai ka me personalitet të jetës ndërkombëtare dhe me kontaktet me kryetarin e qeverisë dhe me ministrin e jashtëm të shtetit të vetë, kryetari i shtetit edhe në demokracitë parlamentare ka një ndikim të rëndësishëm vendimmarjen e politikës së jashtme dhe me kontaktet e veta, mund të jap kontribut në realizimin e interesave të shtetit në marrëdhëniet ndërshtërore.¹⁸

¹⁶ De Gol udhëhiqte një politikë nacionaliste të jashtme franceze, gjatë tërë kohës ai u mundua që Francën ta kthej në kohën e Napoleonit ku ajo dominonte plotësisht botën. Shih për më tepër : Driton Tali "Integrimi i Evropës në UE" Universiteti Mbretëror Iliria, Prishtinë, 2008, fq 471

¹⁷ Petriç Ernest, "Politika e Jashtme" Kolegji Universitar Victory, Prishtinë 2012, fq 339

¹⁸ Po aty, fq 340

KAPITULLI II: Roli i Presidentit të shtetit sipas Kushtetutës (Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova)

2.1 Zgjedhjet e para Presidenciale në shtetin e pavarur të Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i parë shumëpartiak i Republikës së Maqedonisë u konstitua më date 8 janar të vitit 1991 dhe ky Kuvend miratoi Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë më 17 nëntor të vitit 1991.¹⁹ Pas konstituimit të parlamentit shumëpartiak u intensifikuan edhe bisedat rreth kandidatit të mundshëm për kryetar shteti. Zgjedhja e kryetarit për Maqedoninë ishte me rëndësi të veçantë, nga shkak se në këtë periudhë intezivisht zhvilloheshin bisedat për ardhmërinë e Jugosllavisë.²⁰

Pas shumë kalkulimeve dhe pazarllëqeve, në mbledhjen e Kuvendit të 19 janarit, deputeti i LKM – Partia për Transformim Demokratik, Tito Petkovski, para deputetëve e lexoi propozimin e njëzet e dy deputetëve që e mbështetnin kandidaturën e Kiro Gligorovit për kryetar Republike. Fill pas propozimit deputetet e VMRO-së kërkuan sqarim në lidhje me shtetësinë dhe vendqëndrimin e kandidatit të propozuar. E gjithë kjo fliste qartë se forcat politike në parlament nuk i kishin harmonizuar qëndrimet për zgjedhjen e kandidatit për kryetar shteti. Edhe krahas faktit që Gligorov kishte një mbështetje të fuqishme nga partitë joparlamentare dhe opinion publik, ai në përpjekjen e parë nuk fitoi besimin e deputetëve. Për të nuk votuan gjysma e deputetëve, ndërsa për t'u bërë kryetar ai duhej ta fitonte besimin e dy të tretave të parlamentarëve, gjegjësisht duhej të fitonte minimum 80 vota. Edhe pse votimi për kryetar ishte me vota të fshehta, supozohet se besimin Kiro Gligorovit nuk ia dhanë deputetët e VMRO – DPMNE-së dhe të PPD- PDP-së, nga shkak se 37 fletëvotime ishin të shkarravitura ndërsa në 23 fletvotime nuk qëndronte kurrefarë shenje. Kjo normalisht nuk mund të vërtetohet me saktësi. Pas dështimit të këtij propozimi të 22 propozuesve, deputetë në Parlamentin e Maqedonisë që u takonin forcave majtiste, VMRO –DPMNE deklaroi se ajo do të propozojë kandidat të saj për kryetar, por kjo nuk ndodhi. Partitë politike ndërkohë i hekurosën qëndrimet, kështu që në

¹⁹ Jusuf Zejneli "Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë" Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë 2013, fq 42

²⁰ Etem Aziri, "Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni", Logos A, Shkup 2004, fq 119

tentimin e dytë deputët e votuan Kiro Gligorovin për kryetar Republike dhe ai në të vërtetë u bë kryetari i parë i Maqedonisë si shtet parlamentar shumëpartiak.²¹

Gligorovi hoqi yllin e komunistit jugosllav dhe veshi gëzofin e nacionslitit tipik serb. Në ndryshim nga vendet tjera, Maqedonia nuk arriti të ngrohet me diellin demokratik, por u lag me shiun e nacionalizmit serb që baltos demokracinë. Projekti i tij ishte kryekëput nationalist, duke shkaktuar rrënimin e perspektives demokratike të vendit. Mendësia e presidentit të parë të Maqedonisë së pavarur ishte majorizimi. Vetëm maqedonasit kishin ekskluzivitetin legal për të vendosur për veten dhe të tjerët. Ky princip nationalist eliminoi formulën e konsensusit për ardhmëri të përbashkët. Ky realitet është tregues se Gligorovi udhëhiqej nga fiksioni serb. Presidenti i parë i shtetit, Kiro Gligorovi, njihet si arkitekti i ndërtimit të konceptit të shtetit sipas fiksionit serbo – jugosllav. Ky koncept është shndërruar tashmë në tërmet që po lëkund shtyllat e drunjta të shtetit.²²

Shikuar nga këndvështrimi i interesit të popullit shqiptar politika e Gligorovit mund të analizohet në dy rrafshë :

1. Në rrafshin e brendshëm – qëndrimi i tij kundrejt popullit shqiptar të Maqedonisë së Veriut dhe

2. Në rrafshin e jashtëm – politika e tij ndaj Kosovës dhe Shqipërisë.

Në politikën e brendshme të Maqedonisë, Gligorovi me kalimin e kohës e qartësoi platformën e tij nacionaliste dhe njëkohësisht antishqiptare dhe antidemokratike. Gjatë kohës përderisa Gligorovi ishte kryetar, në Maqedoninë e Veriut ndodhën shumë kriza, të cilët në esencë kishin karakter antishqiptar. Mund të përmendim :

- Ngjarjet ne Ladorisht
- Sulmet brutale të policisë maqedonase në Bit Pazar të Shkupit
- Sulmet brutale policore kundër ngritjes së Universitetit në gjuhën shqipe në Tetovë
- Afera e armëve
- Sulmet brutale të policisë në Gostivar dhe Tetovë, në korrik, 1997

²¹ Etem Aziri "Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë" Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë 2012, fq 132

²² Ylber Lili, "Maqedonia në darën e krizave", Tringa Design, Tetovë 2009, fq, 119-120

- Proceset e montuara politike kundër udhëheqësve shqiptarë të komunave të Tetovës dhe Gostivarit;
- Projekti fazhizoid për “transportimin” e kosovarëve nëpër “korridorin” e tij (Gligorovit)

Në politikën e jashtme, Gligorovi afirmoi tezën e “politikës së ekuidistancës”. Në fakt, ai zgjedh tezën më të papërshtatshme për interesin kombëtar shqiptar, sepse politika e këtillë përpqej të copëzoj substancën kombëtare dhe politikën globale shqiptare. Një politik e tillë ishte në favor të qarqeve ekspansioniste serbe dhe filialave të tyre në Maqedoninë e Veriut, të cilët synonin “pastrimin” e shqiptarëve nga Kosova dhe trojet tjera etnike. Sipas logjikës politike të ekuidistancës, çfarë do që të ndodhte në Kosovë, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut duhej të bënin “sehir”. Me fjalë të tjera, edhe nëse në Kosovë shpërthente lufta e armatosur, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk duhej të përziheshin në “çështjen e brendshme të Serbisë”²³

²³ Zeqirja Rexhepi “Zhvillimet politiko –shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001”, Tringa Design, Tetovë 2005, fq 36-37

2.2 Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kryetari i Republikës zgjedhet në zgjedhje të pëgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, për kohën prej pesë vjetësh. I njejti person nuk mund të zgjedhet për kryetar të Republikës më shumë se dy herë gjatë jetës së tij. Kandidat për Kryetar të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë.

Me Kushtetutë janë përcaktuar disa kushte, të cilat duhet t'i përmbush kandidati për Kryetar : ai doemos duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të ketë të mbushur së paku 40 vjet dhe të ketë qenë banorë i Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku dhjetë vjetë brenda 15 viteve të fundit.²⁴

Për Kryetar të Republikës është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve. Në qoftë se në rrethin e parë asnjë kandidat për Kryetar nuk e ka fituar shumicën nevojshme të votave, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar më së shumti vota. Rrethi i dytë i votimit mbahet në afat prej 14-të ditësh nga përfundimi i rrethit të parë të votimit. Për kryetar është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më tepër se 40% nga zgjedhësit. Në qoftë se edhe në rrethin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura e zgjedhjeve. Në qoftë se për Kryetar të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në rrethin e parë të votimit nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura e zgjedhjeve. Zgjedhja e Kryetarit të Republikës bëhet në 60-të ditët e fundit të mandatit të Kryetarit të mëparshëm. Në rast të ndërprerjes të mandatit të Kryetarit të Republikës nga cilat do shkaqe, zgjedhja e Kryetarit bëhet në afat prej 40 ditësh nga dita e ndërprerjes së mandatit.²⁵

Para marrjes së detyrës, Kryetari i posa zgjedhur i Republikës jep deklaratë solemne para Kuvendit, me të cilin rast obligohet se do ta rrespektojë Kushtetutën dhe ligjin. Në rast të vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë së përhershme që ta ushtrojë funksionin ose ndërprerjes së

²⁴ Mersin Maksuti "E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë" Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq 192-193

²⁵ Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Furkan ISM, Shkup, 2015, fq 365 – 366.

mandatit sipas fuqisë së Kushtetutës, funksionin e tij deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri të Republikës e ushtron Kryetari i Kuvendit. Kushtet për ndërprerjen e funksionit të Kryetarit të Republikës i vërteton Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas detyrës zyrtare.

Mandati i Kryetarit të Republikës vazhdohet gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtzakonshme për aq kohë sa zgjatë ajo gjendje (neni 128).

Kryetari i Republikës gëzon imunitet. Për marrjen e imunitetit të tij vendos Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut me shumicë prej 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vetë.²⁶

2.3 Kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si shef individual i shtetit, i ushtron të drejtat dhe obligimet e veta në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe të ligjeve. Funksionet më të rëndësishme të tij janë funksionet standard, e të cilat i hasim te çdo shef individual në shtetet dhe sistemet bashkohore : ai e përfaqëson Republikën dhe është dhe është komandant supreme i Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut.²⁷

Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut i ushtron kompetencat në vijim :

- Cakton mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ;
- Emëron dhe revokon me dekret ambasadorët dhe përfaqësuesit e Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit;
- Pranon letrat kredenciale dhe revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatik
- Propozon dy gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

²⁶ Mersin Maksuti "E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë" Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq, 194.

²⁷ Mersin Maksuti "E drejta kushtetuese e republikës së Maqedonisë" Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq 191

- Propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor Republikan;
- Emëron tre anëtar të Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- I propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike ;
- Emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetut dhe me ligj;
- Ndan dekorata dhe mirënjohje në përputhje me ligjin ;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë.
- Bën faljen në përputhje me ligjin.²⁸

Falja u jepet *personave të caktuar në mënyrë nominale me vendim*, kurse kompetent për falje është Presidenti i RMV (neni.84 i Kushtetutës). Procedura për falje është e caktuar me ligjin për falje i cili dallon në bazë të kërkesës së kryerësit dhe sipas detyrës zyrtare kur Presidenti i shtetit do të vlerësoj se për këtë ekzistojnë shkaqe të caktuara! Që të mos vihet në shprehje, dëshirë arbitrare që lë hapsirë për keqpërdorim, posaçërisht kur kanë për pasojë abolicionin, vendimi për falje duhet gjithmonë të jetë i arsyetuar edhe më shumë nëse bëhet fjalë për akt specifik kundër të cilit për dallim prej akteve tjera të vetme (njëpasnjëshëm), nuk është i lejuar asnjë mjet juridik. Falja u jepet **personave të caktuar** në lidhje me **veprën konkrete penale** ose **dënim konkret!** Falje nuk mund tu jepet personave të dënuar për vepra penale kundër : zgjedhjeve dhe votimit; kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual; fëmijëve dhe personave të mitur; shëndetit të njerëzve; prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe presursorëve nga neni 215 dhe të mundësuarit e përdorimit të drogave narkotike nga neni 216 të KPM; kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Kryetari i shtetit nuk mund të jap falje personit, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili vuan dënim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mirëpo është me aktgjykim të gjykatës ndërkombëtare penale. Vendimi për falje nuk mund t'i përkas edhe liritimit prej ndjekjes të ndonjë personi

²⁸ Etem Aziri "Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë" Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012, fq, 242 - 243

në përgjithësi, për çdo vepër të pacaktuar, ose vepra të ardhshme, sepse në këtë rast do të thoshte tejkalim i kompetencave kushtetuese dhe pranim i imunitetit absolut të atij personi.²⁹

Sipas Ligjit të Agjencionit për zbulim (29, mars, 1995), Kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron dhe shkarkon Drejtorin i cili udhëheq me këtë agjencion dhe zgjedhet në kohën prej katër vjet (Neni 3)

Sipas Ligjit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, anëtarët e Këshillit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç zëvendësguvernereve, i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas propozimit të Presidentit në kohën prej shtatë vjetësh. Guvernarin e Bankës popullore, e emëron dhe e shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kohën prej shtatë vjetësh dhe me të drejtë edhe të një rizgjedhje (neni 60, paragrafi 1 dhe neni 70, paragrafi 1)³⁰

Presidenti i Republikës është Kryetar i Këshillit për Siguri të Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili përbëhet nga : Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Qeverisë, ministrant te fushta e sigurisë, mbrojtjes dhe të punëve të jashtme dhe tre anëtar të cilët i emëron Presidenti i Republikës. Këshilli shqyrton çështjet lidhur me sigurinë dhe mbrotjen e Republikës dhe i jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë.³¹

²⁹ Kambovski Vllado "E drejta penale" (pjesa e përgjithshme), Furkan ISM, Shkup, 2010, fq. 632 - 633

³⁰ Mersin Maksuti "E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë" Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq 192

³¹ Etem Aziri, "Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë", Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë. 2012, fq 243

2.4 Përgjegjësia e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut mban përgjegjësi para zgjedhësve që e kanë zgjedhur. Kjo është përgjegjësi politike e tij.

Si organ i pavarur shtetëror, të drejtat dhe obligimet e veta, Kryetari i Republikës i ushtron në bazë dhe në suazat e Kushtetutës.³²

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Republikës mban përgjegjësi, për shkeljen e kushtetutës dhe të ligjeve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të veta. Procedurën për vërtetimin e përgjegjësisë të Kryetarit të Republikës e ngre Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Për përgjegjësinë e Kryetarit të Republikës vendos Gjykata kushtetuese me shumicë prej dy të tretave të votave (6 vota) nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve. Nëse gjykata kushtetuese e vërteton përgjegjësinë e Kryetarit të Republikës, funksioni ndërpritet sipas fuqisë së Kushtetutës. Siç shihet bëhet fjalë për përgjegjësi politike të pjesshme, e jot ë plotësi te sistemi kuvendor. Procedura për vërtetimin e përgjegjësise së Kryetarit të Republikës është rregulluar me Rregulloren e punës së Kuvendit v. 2008 dhe Rregulloren e Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 1992. Propozimin për ngritjen e procedures për vërtetimin e përgjegjësise së Kryetarit të Republikës mund ta paraqesin së paku 30 deputetë. Propozimi përmban arsyetimin e shkaqeve për ngritjen e procedures, përshkrimin e provave të veprimeve me të cilët Kryetari i Republikës ka shkelur Kushtetutën dhe ligjet. Kuvendi në afat prej 5-së ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit themelon komision për vlerësimin e besueshmërisë së propozimit, i cili ka kryetarin dhe 10-të anëtarë të cilët me propozim të Komisionit për çështje zgjedhjesh dhe emërimesh i zgjedh Kuvendi, me ç'rast sigurohet përfaqësimi adekuat i deputetëve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve që nuk janë të organizuar në grupe parlamentare. Komisioni në afat prej 7 ditësh nga dita e themelimit të tij i paraqet raport Kuvendit. Kryetari i Kuvendit menjëherë e njofton Kryetarin e Republikës për themelimin e komisionit. Kryetari i Republikës mund t'i

³² Mersin Maksuti "E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë" Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq 195

paraqes komisionit sqarim me shkrim lidhur me të dhënat dhe konstatimet e propozimit për ngritjen e procedures për vërtetimin e përgjegjësisë së tij.³³

Kryetari i shtetit së paku njëherë në vit është i obliguar ta njoftojë Kuvendin për veprimtarinë e tij. Kjo njëkohësisht paraqet edhe një nga format e ndikimit të Kuvendit në punën e tij.³⁴

³³ Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Furkan ISM, Shkup, 2015, fq 358-359

³⁴ Jusuf Zejneli, "Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë" Universiteti shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013, fq 146.

3. Roli i Presidentit të shtetit të Republikës së Shqipërisë

3.1 Fillet e pluralizmit politik dhe zgjedhjet e para Presidenciale

Tranzicioni demokratik në Republikën e Shqipërisë i filluar në fillimin e viteve të nëntëdhjeta, shënoi fillimin e një procesi të ndryshimeve strukturore, politike, ekonomike, e shoqërore. Fillimi i këtij procesi nuk ishte i lehtë dhe pa pasoja. Si pasojë e një izolimi total pesëdhjet vjeçar dhe i një diktature komuniste, proceset e ndryshimeve demokratike u ndeshën me kundërthënie të thella politike të cilët ngadalësuan tempin e ndryshimeve dhe të stabilizimit të proceseve demokratike në vend.

Shtyllë e pare e fillimit të tranzicionit demokratik në Shqipëri ishte inaugurimi i pluralizmit politik dhe i demokracisë parlamentare. Fundi i viteve 80-ta përmbylli epokën e monizmit duke hapur derën pluralizmit politik dhe alternativave të reja politike. Kalimi nga monizmi në pluralizëm politik nuk ishte një proces i lehtë dhe gjithmonë paqësorë. Jo rrallë, ai shoqërohej me manifestime të dhunshme dhe përpjekje e përmbyseje politike me përdorimin e forcës³⁵. Këto procese sikur zbehën imazhin e Shqipërisë dhe aftësinë e saj që në mënyrë civilizuese dhe qytetëruese të zhvilloj ndryshime demokratike.³⁶

Më 30 prill 1991, në postin e presidentit, kandiduan Ramiz Alia (proponuar nga Xhelil Gjoni) dhe Namik Dokle (proponuar nga Ahmet Kamberi), ndërsa opozita nuk paraqiti kandidaturë. Ndonëse Doklen e propozuan 31 deputet, por e votuan vetëm 2 vetë. Deputeti punist Ndriçim Hysa, ndonëse ishte në grupin që kishte propozuar kandidat Namik Dokle, bëri thirrje që të

³⁵ Rebelimi i vitit 1997, ndryshe e njohur edhe si Kriza piramidale, e cila solli vendin buzë një kaosi dhe një anarkie, e cila u demonstrua edhe me sulme me armë dhe përdorim të forcës ndaj grupeve të ndryshme. Shkaku i këtij rebelimi dhe dhune ishte falimentimi i skemave piramidale të cilët moren me vete shuma të mëdha të kursimit e shqiptareve,.

³⁶ Bajrami Arsim, "Demokracia Parlamentare" (botimi i katërt), "Flaka" Shkup", Prishtinë, 2005, fq, 278

votohej për Ramiz Alinë. Deputetët e opozitës u shfaqën kritik ndaj figures së Ramiz Alisë³⁷ dhe e shprehën votën e tyre kundër. Në fund, kryetari i komisionit të votimit, Panajot Barka, shpalli Ramiz Alinë president me 172 vota të marra. Pasi u betua, Alia u shpreh i gatshëm për bashkëpunim. Ai shpalli më pas të tërhiqej prej çdo detyre në Partinë e Punës pasi edhe ligji i ri kushtetues kërkonte një president të pavarur nga partitë. Më 4 maj 1991, PPSH zhvilloi Plenumin e 17-të të KQ të saj, duke liruar nga detyra e sekretarit të parë Ramiz Alia si dhe duke caktuar datën e Kongresit të 10-të të kësaj partie më 10 qershor 1991. Dekreti i parë që nënshkroi me 3 maj 1991 Ramiz Alia pas zgjedhjes së tij si President, ishte emërimi i Fatos Nanos kryeministër.³⁸

Në kohën e Ramiz Alisë, diplomacia shqiptare vazhdoi të funksiononte njëanshmërisht, pra vetëmshmesion i ideve, mesazheve e i propagandas zyrtare nga Tirana në terrenin ndërkombëtar dhe jo si informuese, raportuese, analitike, parashikuese e rekomanduese për politikën e shtetit të vet nga terreni ndërkombëtar në Tiranë. Diplomacia e Alisë vijoi të ishte repart politik ndërkombëtar i udhëheqjes partiake shqiptare. Diplomacia e Alisë trashëgoi, madje thelloi pesë sëmundjet e diplomacisë së Hoxhës : së pari, sëmundjen e diplomacisë reaguese dhe jo proaktive; së dyti, sëmundjen e diplomacisë amatore, pra pa dije fundamentale dhe pa fizionomi të qartë kombëtare, së treti sëmundjen e diplomacisë së indoktrinuar politiko –partiake pa elemente realizimi dhe pragmatizmi; së katërti, sëmundjen e diplomacisë deklarative dhe jo të gjallë biseduese e negociuese; së fundi, sëmundjen e diplomacisë së faktit të kryer, pra të zgjidhjeve të rastit, të papërgaditura ose të detyruara.³⁹

Për dyzetepesë vjet, zgjedhjet në Shqipëri kishin qenë një farsë. Në fletët e votimit kishte vetëm një kandidat nga Partia e Punës, dhe një letër e palosur, e pa shenjuar, përbente vote të vlefshme. Tani shqiptarët kishin fshehtësi dhe mundësi për të zgjedhur.⁴⁰

Mendohej gjerësisht se Alia do të jepte dorëheqjen si president pavarësisht nga rezultati i zgjedhjeve ose shkalla e fitores së opozitës. Pas verës 1991 ishte shtuar presioni për dorëheqjen e

³⁷ Ramiz Alia ishte pasardhësi i diktatorit Enver Hoxha dhe duke pasur parasysh këtë fakt por edhe atë të një oponenti politik i cili ishte edhe kryetar i Partisë së Punës e cila më pas u emërua Partia Socialiste, rival të PD-së, ishin arsytet që opozita e atëherëshme votoi kundër.

³⁸ Dervishi Kastriot, " Historia e shtetit shqiptar 1912 – 2005" , 55, Tiranë, 2006, fq 808, 809

³⁹ Bashkurti Lisen, "Diplomacia e vetëizolimit" , Geer, Tiranë, 2004, fq, 699

⁴⁰ Abrahams C. Fred "Shqipëria e re" ,Dudaj, Tiranë, 2015, fq, 149.

tij. Pasardhësi i Enver Hoxhës, i cili kishte qenë dëshmitar i shkatërrimit gradual të pushtetit komunist, kishte humbur çdo besueshmëri. Me gjithë deklaratat e tij se ai mbështet plotësisht demokratizimin e jetës politike të Shqipërisë, deri në fund Alia u qëndroi besnik idealeve komuniste. Por ajo që kishte më shumë rëndësi, tani ai nuk kishte as përkrahjen e Partisë Socialiste. Duke dëshiruar ta bindnin popullin se partia e tyre ishte parti e re, udhëheqësit socialistë nuk e ftuan Alinë që të bëhej anëtar i partisë. Në një deklaratë të dhënë me 3 prill 1992 në radiotelevizionin kombëtar, vetëm pak ditë pas njoftimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, Alia njoftoi se po jepte dorëheqje ‘për të mirën e atdheut’ . Ai shprehu shpresën se parlamenti i ri do t’i ‘besonte udhëheqjen e vendit një personaliteti të ri që do të jetë në gjendje të udhëheq Shqipërinë sipas vullnetit të shumicës’. Parlamenti pranoi dorëheqjen e tij pa kurrëfarë debati. Dalja pa ceremoni e Alisë nga politika shqiptare shënonte fundin e një epoke që i kishte sjell aq shumë mjerim kombit shqiptar.⁴¹ Transferimi i pushtetit nga Ramiz Alia te Sali Berisha, presidenti i parë paskomunist i Shqipërisë u krye në mënyre paqësore dhe të qetë. Në të vërtetë kjo ishte hera e parë në historinë e Shqipërisë që ndryshimi nga një lloj regjimi tek tjetri të kryhet pa dhunë. Me këtë ngjarje shumë të rëndësishme Shqipëria nisi rrugën e vështirë të tranzicionit nga një sistem totalitar, hegjemonist, i një partie, drejtë një demokracie pluraliste.⁴²

Fitorja e Partisë Demokratike me 92 vende në 140 gjithsej, kundrejt 38 vendeve të Partisë Socialiste, të Drejtave të Njeriut (ish – Omonia), vendos Sali Berishën në postin e Presidentit të Republikës dhe krijon qeverinë e parë pa komunistë, të drejtuar nga Aleksandër Meksi.⁴³

Gjatë fjalës së tij para deputetëve, presidenti i ri ndër të tjera tha se detyra e re ishte ‘sa me përgjegjësi aq edhe dhe dinjitoze’. Ai bëri një përkrahje të asaj që kishte kaluar vendi gjatë regjimit komunist, gjendjen ku ai e kishte çuan Shqipërinë duke thënë se në rrethana të tilla, askush nuk do të mund të mëtonte pushtet. Por Berisha e pranonte detyrën me optimizëm me ndjenjën e krenarisë së të qenit shqiptar, duke pasur ‘besim të pakufishëm tek njeriu’. Ai shpalli përparësi të punës së tij, vendosjen e rendit, veprimin e shtetit juridik, rifillimin e prodhimit dhe mëkëmbjen e ekonomisë. Presidenti përmendi se vendet mike si SHBA-ja dhe demokracitë e Europës do të ndihmonin Shqipërinë të ecte në rrugën e demokracisë dhe

⁴¹ Elez Biberaj “Shqipëria në tranzicion rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990 – 2010”, AIFS, Tiranë, 2011, fq,200.

⁴² Elez Biberaj “Shqipëria dhe shqiptarët në udhën e rimëkëmbjes” AIFS, 2014, Tiranë, fq, 252

⁴³ Lory Bernard, “Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona” Dituria, Tiranë, 2007, fq,234.

progresit, duke theksuar se ‘‘ëndrra e madhe e çdo shqiptari është integrimi në Europë’’. Berisha u shpreh se do të përkrahte kërkesat e bashkëkombasve tanë përtej kufirit për njohjen e të drejtës së vetëvendosjes. Ndër të parët president që uruan Sali Berishën ishte George Bush, i cili ndër të tjera shkruante : *‘‘Populli amerikan ju uron paraprakisht të mirën që këto arritje të çohen më tej. Mezi pres të bashkëpunoj me ju për të mbështetur programet e reformave në Shqipëri, për të zhvilluar plotësisht marrëdhëniet tona dhe për të kontribuar në ndërtimin e një bote të re të mbështetur mbi vlerat themelore të përbashkëta’’*⁴⁴

Duke shuar shpresën e një rregullimi të shpejtë të gjendjes, presidenti Berisha shfrytëzoi popullaritetin e tij dhe fitoren e madhe të Partisë Demokratike në zgjedhjet për të krijuar një consensus të gjërë politik që do të ndihmonte për zbatimin e programeve të transformimit dhe të rimëkëmbjes ekonomike. Ai filloi një politik të guximshme për hapjen e Shqipërisë dhe zhvillimin e marrëdhënieve me Perëndimin, sidomos me Shtetet e Bashkuara. Duke theksuar se vendi i tij duhej të niste nga fillimi, Berisha u përpoq t’i bindte demokracitë perëndimore që Shqipëria të trajtohej si rasti i veçantë për arsye të natyrës shumë shtypëse të sundimit të kaluar komunist dhe të izolimit të gjatë të vendit nga bota e jashtme.⁴⁵

Berisha e shikonte vendosjen e shtetit ligjor dhe reformimin e sistemit gjyqësor si çështje të ngutshme politike. Sistemi gjyqësor kishte dekada që nuk funksiononte, i shpërdoruar nga ata që ishin në fuqi për të përjetësuar sundimin e vet, pa shikuar fare drejtësinë. Në një fjalim të mbajtur në korrik 1992, Berisha pohonte : *‘‘Ndërtimi i një sistemi gjyqësor që të funksionojë është kusht themelor për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe për integrimin e Shqipërisë në Europë. Fati i Shqipërisë dhe i mbarë kombit shqiptar varet nga sa do të jemi në gjendje të krijojmë një shtet që bazohet në ligj. Por një kusht edhe më themelor është respekti i ligjit dhe mbrojtja e tij. Kjo është pikënisja e çdo demokracie. Një shtet që nuk respekton ligjin që shpreh vullnetin e popullit do të respektojë vullnetin e një personi të vetëm ose të një grupi personash, siç ka ndodhur në të kaluarën në vendin tone, ose ndryshe do të sundojë anarkia. Mbrojtja e ligjeve*

⁴⁴ Dervishi Kastriot ‘‘Historia e shtetit shqiptar 1912 – 2005’’, 55, Tiranë, 2006, fq, 827,828

⁴⁵ Elez Biberaj ‘‘Shqipëria në tranzicion rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990 – 2010’’, AIIIS, Tiranë, 2011, fq, 208.

*demokratike dhe respekti për to janë pikënisja e çdo demokracie, domosdoshmëri e tyre themelore.*⁴⁶

3.2 Zgjedhja dhe mandati i Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Shqipëria është dhe mbetet një republikë parlamentare, ku institucioni i Presidentit ka rol përfaqësues dhe kordinues, por ku kompetencat ekzekutive dhe legjislative i janë deleguar dy pushteteve përkatëse kushtetuese. Zgjedhja e vitit 1991 për President të zgjedhur në parlament kishte tri shpjegime : *së pari*, kalimi nga regjimi i vjetër ku lideri i PPSH ishte njëherësh edhe Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor (kryetar shteti) ndikoi në gjetjen e një forme zgjedhjeje që nuk lejon një President aktiv politik; *së dyti*, vetë Ramiz Alia nuk ishte i interesuar për zgjedhje direkte dhe Presidenti konsiderohej një produkt i elitës politike, pra i parlamentit; dhe *së fundi*, modelet e demokracive të reja në shumicën e vendeve ish komuniste ishin të njehta, zgjedhje përmes parlamentit.⁴⁷

Më 1998 Shqipëria forcoi komponentin e zgjedhjes përmes parlamentit, duke detyruar me kushtetutë, zgjedhje sa më përfaqësuese dhe konsensuale. Formula e zgjedhjes me pesë raunde me tre të pestat e votave diktoi nevojën e konsensusit, kompromisit dhe zgjerimit të votës politike të mazhorancës siç dhe praktikisht ndodhi në dy zgjedhjet presidenciale pasuese më 2002 dhe 2007. Me ndryshimet kushtetuese 2008 partitë kryesore tentuan uljen e ndjeshme të profilit kushtetues e përfaqësues të Presidentit, duke e shndërruar atë në të paktat institucione që mund të zgjidhen nga çdo mazhorancë e aftë të krijoj dhe qeverinë. Zgjedhja e Presidentit 2012

⁴⁶ Po aty, fq 209

⁴⁷ Krasniqi, A. "Institucioni i Presidentit të Republikës: Problematika rreth kornizës kushtetuese të formimit dhe kompetencave të tij", Punime Akademike mbi nevojën e ndryshimeve kushtetuese, Prill 2015, fq, 9

reflektoi pasojat e këtij ndryshimi, duke prodhuar zgjedhje të rëndësishme partiake, praktikë që vijon të jetë në fuqi edhe për zgjedhjet e radhës 2017. Vendimmarrësit e hartimit të Kushtetutës (1998) apo ndryshimeve kushtetuese (2008) nuk i kushtuan rëndësi nevojës së rishikimit të formulës së zgjedhjes së Presidentit dhe kufizimit të ndjeshëm të zgjedhjes direkte të institucioneve politike kushtetuese nga qytetarët. Me sistemin e ri zgjedhor proporcional rajonal, lista të mbyllura, Shqipëria bëhet ndër vendet e vetme në ish pjesën komuniste të Evropës, ku asnjë institucion qendror nuk zgjidhet totalisht ose pjesërisht direkt nga qytetarët. Aktualisht të gjitha vendet rajonale me përvojë të njëjtë në të kaluarën (Sllovenia, Kroacia, Bullgaria, Rumania, Maqedonia, Sërbia, Mali i Zi), aplikojnë zgjedhjen e Presidentit direkt nga qytetarët. Kosova ka miratuar akordin politik për ndryshime kushtetuese dhe kalimin në zgjedhje direkt të kreut të shtetit. Shqipëria është vendi i vetëm që i mbetet besnik modelit të vjetër të zgjedhjes në parlament. Dallimet midis zgjedhjes në parlament dhe zgjedhjes direkt, nuk lidhen me nurmin e kompetencave apo me profilet politike të kandidatëve fitues. Ka të bëjë më shumë me autoritetin moral dhe besimin qytetar me prestigjin dhe kulturën e përfaqësimit, me garancitë morale dhe të drejtën e veprimit në emër të (qytetarëve, jo deputetëve) ⁴⁸ Presidenti zgjidhet nga kuvendi. Pra, është fjala për një zgjedhje të tërthortë të tij, përderisa ai zgjidhet nga përfaqësuesit e gjithë trupit zgjedhor. Kushtetuta përcakton edhe kushtet për zgjedhjen e Presidentit, ku spikasim kushti i shtetësisë, i moshës dhe i vendqëndrimit. Kandidati për President duhet të jetë shtetas shqiptar që nga lindja dhe të ketë mbushur moshën 40 vjeç. Vendbanimi prej jo më pak se 10 vjetësh në Shqipëri nuk i pengon subjekte të diasporës, ose që kanë banuar për një kohë të gjatë jashtë Shqipërisë, të kandidoj për postin e Presidentit të Republikës, nëse kanë deri 10 vjet që qëndrojnë në Shqipëri. Kushtetuta parashikon zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi me një procedure disi të komplikuar. Kjo është bërë me qëllim që të arrihet pavarësia e tij nga pushteti politik dhe qendrueshmëria e postit të tij, moment të cilat janë shumë të domosdoshme për kryerjen e rolit të tij si mediator institucionesh. Për zgjedhjen e Presidentit, Kushtetuta kërkon një shumicë të cilësuar prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit (87/1-9). Në këtë mënyrë, zgjedhja me një shumicë të tillë të Presidentit, duhet të bëhet përmes negociatash dhe mund të realizohet mbi bazën e kompromisit. ⁴⁹

⁴⁸ Po aty, fq, 10

⁴⁹ Anastasi, A. "E drejta kushtetuese" Pegi, Tiranë, 2003, fq, 184

Kështu, kandidatët për president, pasi propozohen nga grupe prej jo më pak se 20 deputetësh, votohen me votim të fshehtë dhe pa debat, me shumicë të cilësuar deri në pesë herë. Nëse edhe pas 5 votimeve radhazi, asnjë prej kandidatëve nuk e ka marrë shumicën e kërkuar, Kuvendi shpërndahet dhe brenda 60 ditësh bëhen zgjedhje të reja të përgjithshme. Kuvendi i ri i zgjedhur do të procedojë në të njejtën mënyrë sikurse Kuvendi i mëparshëm. Nëse edhe kuvendi i ri i zgjedhur rishtazi, nuk e arrin të zgjedh Presidentin, atëher shpërndahet dhe brenda 60 ditëve bëhen zgjedhje të reja të përgjithshme. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Kjo zgjedhje mjaftë e ndërlikuar përbën një siguri për kompromis me opozitën dhe për qendrueshmërinë e postit të Presidentit. Pas zgjedhjes së tij, Presidenti bën betimin sipas formulës së parashikuar në Kushtetutë (neni 88/3) dhe që nga ky moment, fillon zyrtarisht detyrën.⁵⁰

Procedura që parashikon Kushtetuta shqiptare për zgjedhjen e Presidentit të Republikës ka ngjashmëri me procedurat e parashikuara nga Kushtetuta e Italisë dhe Greqisë me ndryshimin që në Itali në zgjedhje marrin pjesë jo vetëm anëtarët e Dhomës së deputetëve dhe të Senatit, por edhe të deleguarit të Këshillave rajonale (regjionale), ndërsa në Greqi njësoj si në Shqipëri – vetëm deputetët, meqenëse edhe në Greqi Parlamenti ka vetëm një Dhomë. Por procedura për zgjedhjen e Presidentit në Itali është shumë më e thjeshtë, sepse ajo bëhet me një shumicë prej dy të tretash të asamblesë zgjedhore dhe pas votimit të tretë mjafton shumica absolute. Mendojmë se edhe procedura e parashikuar nga Kushtetuta shqiptare, e cila është me të vërtetë e zgjatuar dhe e ndërlikuar kishte vend për thjeshtësim. Kjo procedure me sa duket synon që t'i verë deputetët para dilemës : ose të zgjedhin presidentin e Republikës, duke gjetur një rrugë marrëveshjeje ndërmjet grupeve të ndryshme parlamentare, ose të pranojnë zgjedhje të reja, që mund të mos u sigurojnë atyre rizgjedhjen si anëtarë të Parlamentit.⁵¹ Kushtetuta (1998) bëri ndryshime nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese (1991) lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës, duke kushtëzuar arritjen e shumicës së cilësuar të votave. Me sistemin e zgjedhjes mbi 84 vota janë zgjedhur dy Presidentët (*Moisiu 2002 dhe Topi 2007*).⁵² Ndryshimet

⁵⁰ Po aty, fq 185

⁵¹ Omari, L. "Shteti i së drejtës" (botimi i dytë), Elena Gjika, Tiranë, 2004, fq, 102

⁵² Pas një debati të madh në shqipëri se cili duhej të ishte president i vendit dhe pas një presioni edhe të ndërkombëtarëve të cilët kërkonin një presidenti konsensual, më në fund Nano dhe Berisha u ulën dhe u dakorduan që Alfred Moisiu të ishte presidenti konsensual, i cili u zgjodh president me 24 korrik 2002, ndërsa

kushtetuese 2008 e ndryshuan formulën, duke kaluar në zgjedhjen e Presidentit me shumicën e votave së të gjithë deputetëve, formulë me të cilën është zgjedhur një President (*Nishani, 2012*)⁵³ Me amandamentet e 21 prillit 2008 të Kushtetutës së Shqipërisë procedura e zgjedhjes së Presidentit ndryshoi rrënjësisht. Si rrjedhojë tani për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime, tani secili nga votimet zhvillohet jo më vonëse shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit të mëparshëm. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurim nuk paraqitet asnjë kandidat. Ne votimin e dytë, të tretë e të katërt mund të paraqiten kandidat të rinjë, po të propozohen nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Në tri votimet e para zgjidhet si President kandidati që merr jo më pak se tri të pestat e votave, pra të 84 deputetëve. Ndërsa në votimin e katërt dhe të pestë për t'u zgjedhur mjafton sigurimi i votave të më shumë se gjysmës së të gjithë antarëve të Kuvendit, pra mjafton shumica absolute (71 vota).⁵⁴ Përfundimisht nëse edhe pas votimit të pestë asnjëri nga kandidatët nuk siguron shumicën absolute, Kuvendi shpërndahet dhe brenda 45 ditëve zhvillohen zgjedhjet e reja. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin me shumicën e të gjithë antarëve të tij. Ky ndryshim i procesurës ngjalli reagime të forta. Procedura e mëparshme u ndryshua me arsyetimin se ajo ishte shumë e gjatë dhe e komplikuar dhe e rrezikonte qëndrueshmërinë politike duke parashikuar që në rastin e skajshëm të zhvilloheshin dy zgjedhje parlamentare brenda një harku kohor prej 4 muajsh për të arritur te zgjedja e një Presidenti me shumicë absolute të të gjithë deputetëve.⁵⁵

Mandati i Presidentit të Republikës së Shqipërisë është pesëvjeçar (neni 88/1 i Kushtetutës), ndryshe nga Parlamenti që ka një mandate katërvjeçar. Me sa duket me këtë ndryshim në zgjatjen e mandatit është synuar të evidentohet shkëputja dhe pavarësia e presidentit nga shumica parlamentare që e ka zgjedhur. Është e qartë që në rast se Parlamenti i ri i zgjidhur, kur ende vazhdon mandati presidencial, ka një shumicë të ndryshme nga ajo zgjedhi presidentin, ky i fundit duhet të "bashkëjetojë" dhe të bashkëpunojë me shumicën e re, çka është në logjikën e sistemit parlamentar.⁵⁶ Mandati i Presidentit mbaron me përfundimin e afatit pesëvjeçar, me shkarkimin e tij nga funksioni (neni 90 paragrafët 2 dhe 3); me vërtetimin përfundimtar në

Bamir Topi u zgjedh president me 20 korrik 2007 me 87 vota, zgjedhja e Topit ishte edhe një pasoje e një mosmarrëveshje në bllokun e së majtës.

⁵³ Krasniqi, A. "Institucioni i Presidentit të Republikës: Problematika rreth kornizës kushtetuese të formimit dhe kompetencave të tij". Punime Akademike mbi nevojën e ndryshimeve kushtetuese, Prill 2015, fq, 10-11

⁵⁴ Luan Omari, Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese", Dajti 2000, Tiranë, 2017, fq, 277

⁵⁵ Po aty, fq, 278

⁵⁶ Omari, L. "Shteti i së drejtës" (botimi i dytë), Elena Gjika, Tiranë, 2004, fq,103

pamundësinë për të ushtruar funksionin e tij. Ndonëse nuk thuhet shprehimisht në Kushtetut, është e kuptueshme që mandati i Presidentit merr fund edhe me vdekjen e tij. Përveç shkaqeve të lartpërmendura, mandati i tij mbaron edhe kur ai jep dorëheqje para përfundimit të afatit dhe në këtë rast, sipas nenit 88/4 të Kushtetutës, ai nuk mund të kandidojë përsëri në zgjedhjet presidenciale që bëhen pas dorëheqjes së tij.⁵⁷

3.3 Kompetencat e Presidentit në raport me institucionet tjera.

Në diskutimet që janë bërë në Shqipëri gjatë procesit të përpunimit dhe miratimit të Kushtetutës⁵⁸, është shtruar edhe problem nëse Presidenti i Republikës është ‘i fortë’ apo ‘i dobët’. Mund të thuhet se pavarësisht se në Kushtetutë vetëm ekzekutivi, dhe jo presidenti, është i ngarkuar të kryej funksione ekzekutive, kjo nuk do të thotë që presidenti është ‘i dobët’. Me kompetencat e tij të gjëra përse i përket emërimit të organeve të kontrollit dhe me rolin e tij si garant i rendit kushtetues, presidenti është një nga institucionet themelore të strukturës kushtetuese.⁵⁹ Kompetencat që i jepen Presidentit të Republikës janë përcaktuar me mjaftë kujdes. Kjo është bërë duke mbajtur parasysh se, ai është vendosur jashtë tri pushteteve në shtet. Pra, ai i ushtron atributet e tij, jo si organ i njerit prej këtyre pushteteve, por thjeshtë si një Kryetar Shteti. Kështu, mund të identifikohen me një pushtet autonom presidencial, që karakterizohet nga funksione që nuk kërkojnë pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të Presidentit në aktivitetin e drejtimit politik. Megjithatë, kompetencat e Presidentit shtrihen në marrëdhëniet e tij me të gjitha pushtetet.

Në marrëdhënie me Kuvendin : cakton datën e zgjedhjeve (92/gj); thërret Kuvendin në mbledhjen e tij të pare (67/1); i drejton mesazhe Kuvendit (92/a); shpall ligjet dhe ushtron të

⁵⁷ Luan Omari, Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese” Dajti 2000, Tiranë, 2017, fq, 282 - 283

⁵⁸ Shqipëria hartoi kushtetutën e re në vitin 1998, sepse ishte vendi që nuk kishte një kushtetut të plot deri në këtë vit, kjo u miratua në parlament dhe me një referendum popullor.

⁵⁹ Omari, L. “Shteti i së drejtës” (botimi i dytë), Elena Gjika, Tiranë, 2004, fq, 104-105.

drejtën e vetos vetëm njëherë (84/1 & 85/1); kërkon mbledhjen e Kuvendit në session të jashtëzakonshëm (74/2); shpërndan Kuvendin, vlerëson kërkesën e 50 mijë shtetasve për të zhvilluar Referendum për çështje të rëndësisë së veçantë (150/1) dhe kur e çmon të arsyeshme vendos për kryerjen e Referendumit;

Në marrëdhënie me qeverinë; Presidenti emëron për herë të parë kandidatin për kryeministër (neni 96); emëron dhe shkarkon ministrat me propozimin të Kryeministrit⁶⁰ (neni 98); kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre (92/h); në marrëdhënie me politikën e jashtme : lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit (92/ë) emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare (92/dh) .

Në lidhje me drejtësinë : Presidenti i emëron gjyqtarët dhe prokurorët, është Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ; ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit (92/b).

Një sërë kompetencash, Presidenti i ushtron në fusha të ndryshme. Kështu ai është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (168/2), akordon gradat më të larta ushtarake (92/d) ; emëron rektorët e universiteteve dhe Kryetarin e Akademisë së Shkencave (92/g); jep dekorata dhe tituj nderi (92/ç); jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit (92/c) etj.⁶¹

Kushtetuta në nenin 92, shkronja ‘d’, duke parashikuar të drejtën e Presidentit të Republikës për të dhënë ‘gradat më të larta ushtarake sipas ligjit’, ka përcaktuar autoritetin e kreut më të lartë të shtetit për të ushtruar këtë kompetencë kushtetuese për ushtarakët madhorë. Sipas nenit 169, pika 3, ‘Presidenti i Republikës, me propozimin të Kryeministrit, emëron dhe shkarkon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore’. Në aplikimin e këtyre kompetencave dhe specifikimeve që burojnë nga ligjet mbi gradat dhe karrierën ushtarake etj, vazhdimisht ka pasur interpretime dhe konflikte edhe kushtetuese midis institucionit të Presidentit dhe Ekzekutivit. Rasti më flagrant ishte ai i prillit të vitit 2012, kur Ministri i Mbrojtjes emëroi Komandantin e flotës detare pa konsultim dhe miratim paraprak të Presidentit,

⁶⁰ Rasti i mos dekretimit të Gent Cakajt si Ministër i Punëve të Jashtme nga Presidenti Ilir Meta, i cili e cilësonte si të pa përvojë dhe kjo u ndërlihd pastaj edhe me debate të shumta për çështjen e korigjimit e kufijve mes Kosovës dhe Sërbisë, në këtë rast Presidenti l’a dha detyren kryeministrit Rama i cili më pas l’a delegoi Cakajt.

⁶¹ Anastasi, A. “E drejta kushtetuese” Pegi, Tiranë, 2003, fq, 187-188.

siç përcaktohet nga neni i mësipërm kushtetues. Konflikti Institucional rrezikoi krizë marrëdhëniet President – Qeveri, por në momentet e fundit Qeveria u tërhoq dhe ministri pranoi gabimin e tij, duke anuluar të gjithë procedurën. Një konflikt i ngjashëm u përsërit në 2014-tën në përpykjen e Ministrisë së Mbrojtjes për të shkarkuar përfaqësuesin ushtarak të NATO-s, pa miratimin paraprak të Presidentit. Gjatë vitit 2014, Qeveria dhe Mazhoranca ndërhyrën me dy akte ligjore për të evituar konflikte të mëtejshme. Në ligjin përkatës (nenet 25, 26) e drejta e Presidentit për të dekretuar daljen në rezervë apo lirim të oficerëve me grade më të larta kalon Kryeministrit.⁶² Në vitin 2004, Presidenti në ushtrimin e kompetencave kushtetuese emëruese, paraqiti në Kuvend dekretin për emërimin e një anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, dekret për të cilin Kuvendi vendosi mosdhënien e pëlqimit. Në këto rrethana, të cilët pa hezitim mund të cilësohen si përplasja e parë institucionale mes dy organeve kushtetuese President – Kuvend, u paraqit në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë nga Presidenti i Republikës me objekt interpretimin e neneve 125/1 dhe 136/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Çështja që shtrohej për diskutim në thelb ishte mosmarrëveshje kompetencash, që në vështrimin e Presidentit të Republikës kishte të bënte me përcaktimin e rolit të Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces dhe kufijve të veprimit të secilit organ kushtetues. Mosmarrëveshja midis Presidentit dhe Kuvendit, si organe të cilave u është ngarkuar zgjedhja e gjyqtarëve kushtetues dhe atyre të lartë, kishte të bënte me sferën dhe natyrën e kompetencave të tyre në procesin (emërim – pëlqimit). Më konkretisht, synohej të përcaktohej roli i Kuvendit në shqyrtimin e dekreteve të Presidentit, me fjalë të tjera nëse kërkesa për dhënien e pëlqimit nga Kuvendi është formale apo substanciale.⁶³

3.4 Roli i Presidentit në papërgjegjshmërinë politike

⁶² Krasniqi, A. "Institucioni i Presidentit të Republikës: Problematika rreth kornizës kushtetuese të formimit dhe kompetencave të tij", Punime Akademike mbi nevojën e ndryshimeve kushtetuese, Prill 2015, fq, 21-22.

⁶³ Valbona Bala (Pajo), "Rrugëtim kushtetues : sfidat, arritjet, perspektiva e Gjykatës Kushtetuese", ARTIC, Tiranë, 2018, fq, 249.

Si rregull “*Presidenti nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij*” neni (90/1). Ai ushtron mandatin e tij të plot dhe asnjë organ kushtetues nuk mund ta detyrojë atë të largohet nga detyra. Edhe kuvendi, organi që e ka zgjedhur, nuk mund t’i heq besimin dhe nuk mund ta detyrojë të jap dorëheqje. Në fakt, kjo përgjegjshmëri në detyrën e kryetarëve të shteteve, është një mit i lashtë. Ai e ka burimin që nga monarkitë mesjetare. Sot, kjo traditë është treguar e qëndrueshme sepse i siguron Kryetarit të shtetit një autonomi dhe pavarësi të domosdoshme për kryerjen e detyrës së tij. Në rast të kundërt ai do të bëhej preh e presioneve politike që mund të vinin nga të gjitha anët. Kur flasim për këtë çështje, duhet të dallojmë *përgjegjësin politike nga përgjegjësia juridike*. Presidenti i Republikës është politikisht i papërgjegjshëm nga pikpamja institucionale. Kjo sepse, përgjegjësia politike e akteve presidenciale merret përsipër nga ministrant propozues ose nga ministrant kompetent, të cilët i kundërfirmojnë këto akte. Këtu, mbajmë parasysh se aktet që kanë vlerën e ligjvënëse dhe aktet e tjera të treguara nga ligji kundërfirmohen nga edhe nga Kryeministri. Është e rëndësishme të kujtohet se kundërfirma ministriale e të gjitha akteve presidenciale është jo vetëm një instrument i përshtatshëm për të marrë përsipër përgjegjësinë e akteve të tilla nga ministrant, por edhe si një kusht i vlefshmërisë së këtyre akteve vetë. Ndryshe shfaqet përgjegjësia juridike e Presidentit të Republikës. Si rregull, ai nuk është përgjegjës penalisht, ashtu edhe civilisht për aktet e përmbushura në ushtrimin e detyrës. Megjithatë, kjo përgjegjësi nuk është absolute. Ka edhe ajo kufizimet e saj, të cilat paraqiten në Kushtetutë. Presidenti është përgjegjës për shkelje të rënda të Kushtetutës, dhe, kur ka kryer një krim të rëndë (neni 90/2) ⁶⁴ Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë, sipas procedurës së parashikuar në paragrafet 2 dh 3 të nenti 90 të Kushtetutës. Kushtetuta nuk sqaron se ç’kuptohet me ‘shkelje të rëndë të Kushtetutës’. Doktrina kushtetuese dhe praktika kushtetuese e vendeve të ndryshme është shprehur se presidenti kryen një shkelje të qëllimshme të Kushtetutës kur ai me paramendim, kryen një veprim ose një mosveprim që bie ndesh me dispozitat e shprehura të Kushtetutës në lidhje me kompetencat që ai ushtron. Presidenti, për shembull, mund të kryej një shkelje të rëndë : ose duke nxjerë një dekret pa kundërfirmën e

⁶⁴ Anastasi, A. “E drejta kushtetuese” Pegi, Tiranë, 2003, fq, 186-187.

duhur të Kryeministrit a të ministrit përkatës ose duke refuzuar të nxjerë një dekret që i propozon Qeveria, sipas kompetencës së saj.⁶⁵

⁶⁵ Omari, L. "Shteti i së drejtës" (botimi i dytë), Elena Gjika, Tiranë, 2004, fq, 105.

4. Roli i Presidentit të Republikës së Kosovës

4.1 Një historik i Presidentit të Kosovës

Pas miratimit të amandamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, u krijua baza kushtetuese për mbajtjen e zgjedhjeve të para demokratike, të lira dhe shumë partiake për zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës dhe Kryetarit të Republikës. Këto zgjedhje u mbajtën me 24 maj të vitit 1992, me pjesmarrjen massive të popullit shqiptar, i cili për herë të parë kishte mundësinë e deklaramit të lirë për zgjedhjen e organeve kryesore të Republikës së Kosovës.⁶⁶ Shikuar nga aspekti historik, Kosova nuk kishte përvoja me presidentët popullor. Në kohën e Kushtetutës së vitit 1974 brenda autonomisë politiko – territoriale që gëzonte kishte modelin e presidencës kolegjiale në formë të Kryesisë së Kosovës. Ky organ u suprimua në vitin 1990 pas suprimimit kundër kushtetues të autonomisë së Kosovës nga Sërbia në fund të vitit 1989. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuar në Kaçanik me 7 shtator 1990, fillimisht parashihej modeli i Kryesisë së Kosovës. Tek më vonë në vitin 1991 u bë amandamenti i kësaj kushtetute me të cilat për herë të parë u aplikua modeli i presidentit të zgjedhur drejtpërdrejt. Në sajë të këtyre amandamenteve në zgjedhjet presidenciale Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh President i parë i Kosovës, për tu rizgjedhur edhe njëherë në të njëjtin funksion në vitin 1996 në zgjedhjet kontroverse, të cilat u mbajtën në kushte okupimi sërb dhe në vigjilje të fillimit të fillimit të rezistencës së armatosur. Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar, mbi bazën e rezolutës 1244 të KS të OKB-së, Kosova miratoj Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme. Sipas kësaj Kornize, Presidenti i Kosovës zgjidhej nga Kuvendi pas një votimi në tri rrethë. Në dy rrethët e pare kërkohet 2/3 e votave, kurse në rrethin e tretë shumica absolute e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ky mekanizëm zgjedhorë ricikloj në vazhdimësi kriza parlamentare sepse zgjedhja e presidentit u bë një shkas i krizave të thella politike. Kështu në vitin 2001 Dr. Rugova u zgjodh President i Kosovës pas dështimeve në dy rrethët e votimit dhe pas një marrëveshje politike për koalicion

⁶⁶ Arsim Bajrami "Demokracia Parlamentare" (botimi i katërt), Flaka, Prishtinë, 2005, fq, 292.

gjithpërfshirës me të cilën, Dr. Rugova si si udhëheqës i LDK-së si parti fituese u detyrua që mandatin për udhëheqje e qeverisë të ja besoj PDK-së si parti e dytë, përkatësisht Dr. Bajram Rexhepit, i cili u emërua kryeministër. E njejtë krizë ricikloj edhe në vitin 2004, ku përsëri në shkëmbimim të postit të Presidentit Dr. Rugova ja besoj udhëheqjen AAK-së, gjegjësisht z. Ramush Haradinajt. Edhe pas zgjedhjeve të vitit 2007 Dr. Fatmir Sejdiu u zgjodh President i Kosovës vetëm pas arritjes së marrëveshjes për koalicion qeverisës midis PDK-së si parti fituese dhe LDK-së si parti e dytë me z. Hashim Thaçi Kryeministër.⁶⁷

4.2 Roli i Presidentit sipas kompetencave

Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon kompetencat e Presidentit në Nenin 84 të saj. Në aspektin numerik, Presidenti i Republikës së Kosovës, ushtron një numër të kompetencave, tridhjetë (30) sosh, mirëpo kjo nuk e bën Presidentin e Kosovës që të dallohet shumë për nga fuqia e tij kushtetuese me presidentët e tjerë, respektivisht ato të sistemeve të tjera, sidomos në republikat parlamentare. Duhet theksuar se për nga kompetencat ose fuqitë e tij kushtetuese Presidenti i Kosovës është president tipik parlamentar dhe nuk ka ndonjë fuqi (kompetencë) të veçantë që e nxjerrë jashtë petkut të një presidenti parlamentar, kjo edhe për faktin se i tërë sistemi kushtetues i Kosovës funksionon, marrë në tërësi, si një sistem parlamentar. Edhe pse disa nuance të kompetencave të Presidentit i japin atij (Presidentit të Kosovës) një fuqi ekzekutive, kryesisht tipike për sistemet kushtetuese gjysmë – presidenciale.⁶⁸ Nga kompetencat më të rëndësishme të presidentit duhet përmendur se ai, përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë, cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike

⁶⁷ Arsim Bajrami “Aspektet e ndryshimeve kushtetuese në Republikën e Kosovës”, CONSTITUTIO – 1/2012, fq, 13.

⁶⁸ Arsim Bajrami, Florent Muçaj “E drejta kushtetuese”, “Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2018, fq, 385.

ose të koalicionit që përbën shumicën e Kuvendit, emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, emëron gjyqtar për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit, etj.⁶⁹

4.3 Modeli i zgjedhjes së Presidentit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh një procedure unike të votimit të Presidentit, e cila është rregulluar me Nenin 86 të Kushtetutës. Procedura e zgjedhjes së Presidentit ka qenë çështje trajtimi edhe në Gjykatën Kushtetuese, pas kontestimit të deputetëve për procedurën e zgjedhjes së ish - Presidentit Behgjet Pacolli sipas rastit KO29/11, i cili rast ka krijuar disa standard për sa i përket procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës një ndër kushtet për zgjedhjen e Presidentit është votimi i fshehtë, i cili është një parim i qartë që duhet të zbatohet në procedurën e zgjedhjes së Presidentit.⁷⁰ Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.⁷¹ Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për

⁶⁹ Përparim Gruda, "Ndarja e pushteteve: analizë kushtetuese", Kolegji Evropian "Juridica", Prishtinë, 2015, fq, 47-48.

⁷⁰ Arsim Bajrami, Florent Muçaj, "E drejta kushtetuese", Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Prishtinë, 2018, fq, 402.

⁷¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 86 para.2

President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.⁷² Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.⁷³ Nëse asnjëri kandidat nuk mer shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës.⁷⁴ Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhje të reja, të cilët duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.⁷⁵ Presidenti i Republikës së Kosovës përveç kushteve për të qenë kandidat, të cilat u treguan më lartë, pas zgjedhjes duhet të plotësoj edhe dy kushtet tjera: e para nuk duhet të mbas asnjë post publik dhe e dyta nuk mund të mbajë asnjë pozitë në ndonjë parti politike. Këto dy kushte kanë të bëjnë edhe lidhen me drejtpërdrejt me unitetin e popullit. Presidenti nuk mund të jetë përfaqësues i mirëfillt i unitetit të popullit nëse mban ose nuk plotëson ndonjërin nga këto kushte të përcaktuara me nenin 88 të Kushtetutës të Kosovës. Mbi supozimin tanimë të vërtetuar për shkelje serioze të Kushtetutës, për faktin se kishte mbajtur të ngrirë postin e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kishte përfunduar në Gjykatën Kushtetuese edhe ish – Presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu. Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI47/10 kishte interpretuar që mbajtja e postit të kryetarit të partisë politike dhe të Presidentit në njërin anë përbën një shkelje serioze të Kushtetutës.⁷⁶ Në rastin e dytë, Rasti Nr. 29/11, i 30 marsit 2011, në kuptimin strikt të fjalës, Gjykata nuk ka vlerësuar veprimet (ose sjelljen) e Presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli. Më shumë kishte të bënte me veprimet ose sjelljen e Kuvendit të Kosovës dhe anëtarëve të tij gjatë procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011. Një ditë më parë, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ftoi deputetët për një seancë të jashtzakonshme për ditën e nesërme. Agjenda për këtë seancë të jashtzakonshme kishte të bënte me zgjedhjen e Presidentit të ri, pas dorëheqjes së Presidentit paraprak, z. Fatmir Sejdiu. I vetmi kandidat i propozuar për këtë zyrë ishte z. Behgjet Pacolli. Gjatë votimit i cili

⁷² Po aty, neni 86 par.3

⁷³ Po aty, neni 86 par.4

⁷⁴ Po aty, neni 86, para. 5

⁷⁵ Po aty, neni 86, para.6

⁷⁶ Arsim Bajrami, Florent Muçaj, "E drejta kushtetuese", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2018, fq,407.

ndodhi me 22 shkurt 2011, tri partite opozitare, LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës), AAK (Aleanca për ardhmërinë e Kosovës), VV (“Vetëvendosje”) nuk morën pjesë, kështu që numri i atyre që morën pjesë në proces ishte gjashtëdhjeteshtatë (67) nga njëqind e njëzet (120) deputetë dhe me një kandidat të vetëm Kuvendi i Kosovës pas raundit të tretë zgjodhi z. Behgjet Pacolli si President të Republikës. Brenda tetë ditësh, pra me 1 mars 2011, Sabri Hamiti dhe 33 deputetë tjerë parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar kushtetueshmërinë e procedurës për zgjedhjen e e Presidentit të Republikës së Kosovës siç u bë seancë e jashtzakonshme të Kuvendit të mbajtur me 22 shkurt 2011, duke pretenduar shkeljen e nenit 86 (“Zgjedhja e Presidentit”) të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës në veçanti pohuan se neni 86, paragrafët 4, 5 dhe 6 të Kushtetutës ishin shkelur, në pikpamjen e mungesës së kuorumit të nevojshëm gjatë votimit, mungesën e kandidatit kundërshtar dhe ndërprerjen e votimit gjatë procedurës zgjedhore. Gjykata, pasi që shpalli kërkesën e pranueshme në baza formale, u lëshua në analizimin e meritave në veçanti. Me metodën krahasimit, Gjykata me të drejtë gjeti se kishte shkelje të nenit 86, jo për shkak të kuorumit, i cili ishte një çështje tjetër, por për shkak të faktit se në dy raundet e para është e nevojshme që dy të tretat e deputetëve të marrin pjesë dhe se duhej të kishte më shumë se një kandidat.⁷⁷

⁷⁷ Enver Hasani, “Tema të zgjedhura nga e drejta kushtetuese” Universiteti i Prishtinës; Jalifat Publishing, Prishtinë 2016, fq, 206-207.

Kapitulli III : Dallimet në mes normative dhe reales në funksionimin e Presidentit të shtetit : (Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova)

5.1 Roli i Presidentit të Maqedonisë së Veriut

Kryetari i Republikës zgjidhet në zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike. Por vetë fakti që zgjidhet nga populli (pra qytetarët me të drejtë vote), Presidenti i Republikës ka një legjitimitet të pakontestueshëm. Megjithatë, praktika e vetë zhvillimit të sistemit politik të Maqedonisë na ofron disa raste ku për qëllime të politikës ditore subjekte të caktuara politike dhe poashtu etnitete të caktuara politike kanë kontestuar legjitimitetin e vetë Presidentit të Republikës duke e quajtur atë si : “qytetar” ose “president vetëm i një kombi”. Pra e gjithë kjo duhet nënkuptuar si pasojë e vetë pozitës juridiko – politike të Presidentit të Republikës dhe nivelit të kultures politike në vend.⁷⁸ Shiqvar nga prizmi i pozicionin faktit të Kryetarit të RM-së, sipas pozitës të Kryetarit të Republikës, RM-ja është shtet me sistem parlamentar – presidencial ose model i përzier. Mirëpo kjo varet edhe nga vetë personaliteti që posedon Kryetari, kështu që nëse kemi të bëjmë me një kryetar të aftë dhe karizmatik atëher modelin e përzier e transformon në model presidencial por edhe e kundërta, pra nëse kemi një kryetar të dobët dhe të paaftë atëherë modelin e përzier e transformon në një sistem parlamentar dhe shef të dobët të shtetit, në të.⁷⁹ Këtu mund të përmendim rolin e presidentit Gligorov, që nënshkroi një marrëveshje me

⁷⁸ Etem Aziri “Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë” Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012, fq, 240.

⁷⁹ Jeton Shasivari “E drejta kushtetuese” Furkan ISM, Shkup, 2015, fq, 360.

gjeneralin e asaj kohe të Jugosllavisë, Haxhiç, për një tërheqje të forcave të armatosura të ushtrisë Jugosllave nga Maqedonia. Por se çfarë përmban ajo marrëveshje, ende nuk e dim, sepse ajo nuk u bë asnjëher publike. Ajo marrëveshje nuk u ratifikua në parlament, por një gjë e dim : ushtria jugosllave u tërhoq pa asnjë të shkrepur, për dallim nga republikat tjera të Jugosllavisë dhe për dallim prej Kosovës ku ajo bëri kërdi. Rasti i dytë ishte ai i vitit 2001, kur Maqedonia u gjend në një konflikt të armatosur. Kjo situatë e vendosi në qendër të vëmendjes kryetarin e shtetit, atë kohë kryetar ishte Boris Trajkovski, një besimtar evangjelist që u bë president me zgjedhje të dyshimta, por që mbahet mend si njeriu që shmangi konfliktin e drejtpërdrejtë ndëretnik. Partia VMRO –DPMNE, që asaj kohe udhëhiqej nga Lubço Georgievski, nga i cili u propozua dhe u përkrah, bënte presion të hatashëm që Maqedonia të shpall gjendje lufte dhe në këtë mënyrë të vihej në lëvizje i gjithë arsenali ushtarak. Sipas këshilltarëve të tij në atë kohë, falë karakterit të Trajkovskit, si një besimtar ajo nuk ndodhi. Se kishte presione të të gjitha formave tregon vetë tendenca për grushtet nga njësitë paramilitare ose parapolice, ku ai u detyrua të largohet nga kabineti i tij dhe të strehohej në kazemat ushtarake.⁸⁰

⁸⁰ Rizvan Sulejmani, "Sfidat shqiptare: analiza politike 2007 -2014" Logos - A, Shkup, 2014, fq, 362.

5.2 Roli i Presidentit të Maqedonisë së Veriut në politikbërjen e jashtme

Marrëdhëniet ndërkombëtare janë objekt i rregullimit me kushtetut sepse e drejta e brendshme varet nga e drejta ndërkombëtare. Me këtë Kushtetuta e RM-së, i rregullon marrëdhëniet ndërkombëtare me dy lloje dispozitash, edhe atë : *e para*, respektimin e normave përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare si një vlerë themelore e rendit kushtetues në RM (më këtë rast RM-ja obligohet t'i respsktojë burimet e së drejtës ndërkombëtare , siç janë : marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare zakonore, praktikën e gjykatave ndërkombëtare poashtu edhe doktrinën dhe mendimet e ekspertëve në këtë lëmi) dhe e dyta, dispozitat e Kapitullit IV-të, ku rregullohen edhe disa çështje të kësaj lëmie, siç janë : efekti juridik i marrëveshjeve ndërkombëtare, subjekti për lidhjen e tyre dhe asocimi (dalja) i RM-së në bashkime ose në bashkësi me shtetet tjera.⁸¹ Bazuar në nenin 119 të Kushtetutës marrëveshjet ndërkombëtare lidhen në emër të Republikës nga Presidenti i Republikës. Megjithatë, marrëveshjet ndërkombëtare mund të arrihen edhe nga vetë qeveria e Maqedonisë, por kur një gjë e tillë përcaktohet me ligj. Por ndërkohë, neni 68, parashikon *inter alia (ndër të tjera)*, që Parlamenti ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare. Lidhur me këto dispozita arrihet në përfundim se vetëm Presidenti ka të drejten e lidhjes së traktateve të Republikës, por ndërkohë që rregulli

⁸¹ Jeton Shasivari, "E drejta kushtetuese" Furkan ISM, Shkup, 2015, fq, 322-323.

përrjashtues i jep të njejtën kompetencë edhe Qeverisë, me kushtin që një gjë e tillë të përcaktohet me ligj. i cili nuk mund të jetë veçse një ligj i rangut Kushtetues. Ndërkohë, nga neni 68 del në pah kuptimi që Presidenti mund të lidh traktate me efekt të drejtpërdrejtë lidhjen me traktatet në fjalë pa pasur nevojë për miratimin e Kuvendit përse i përket çështjeve me të cilat traktati kërkohet të ratifikohet nga Parlamenti. Kushtetuta në këtë rast ka lënë që rregullimi të bëhet me ligj të posaçëm.⁸² Por me fjalë të tjera, rasti i Maqedonisë dëshmon se nuk mjafton vetëm zgjedhja e presidentit nga populli, nëse ky legjitimitet demokratik i fituar në zgjedhje, nuk shoqërohet edhe me po aq kompetenca kushtetuese presidenciale (pra edhe me ato në fushën e politikës së jashtme) , që i korrespondojnë kësaj fuqie legjitime demokratike. Madje vetë praktika 20 vjeçare e funksionimit të shtetit të pavarur dhe Sovran të Maqedonisë, dëshmoi se jashta këtyre normave, funksionimi i praktik institucionit të Presidentit varej kryesisht nga konstelacioni i forcave të brendshme politike. Jo rrallë herë ndodhte në periudha të caktuara që kur Presidenti i takonte një partie tjetër - nga ajo që udhëhiqte qeverinë, pati edhe bllokada institucionale për shkak të konfliktit të kompetencave. Kjo sidomos edhe në rrafshin e politikës së jashtme, kur qëndrimet e Presidentit nuk përputheshin me ato të Kryeministrit për çështje të caktuara në marrëdhëniet ndërkombëtare, ose kur propozimet e Qeverisë për emërime dhe shkarkime të ambasadorëve të RM-së nëpër botë, nuk dekretoheshin nga ana e Presidentit të Republikës.⁸³

⁸² Jordan Daci "Kompetencat e Presidentit për lidhjen e traktateve ndërkombëtare – këndvështrim krahasues" Revista Constitutio – 1/2012, fq. 125.

⁸³ Blerim Reka "Presidenti dhe politika e jashtme – një shqyrtim komparativ", revista Constitutio – 1/2012, fq.104

5.3 Presidenti i Republikës në raport me institucionet tjera

Raportet midis Kryetarit të RM-së dhe Qeverisë (kohabitimi) – pra këto raporte janë rregulluar me Kushtetutën e RM-së, Ligjin për Qeverinë e RM-së të vitit 2000 dhe poashtu Rregulloren e punës së Kuvendit të RM-së në vitin 2008. Kushtetuta pra i cakton këto raporte në tri nivele : pjesmarrja e ndërsjellë e ushtrimit e disa punëve të pushtetit ekzekutiv ; besimi i mandatit për formimin e qeverisë dhe poashtu bashkëpunimi i ndërsjell në pushtetin ekzekutiv. Sipas Kushtetutës, Kryetari i Republikës dhe Qeveria janë organe të pushtetit ekzekutiv mirëpo në vëllime të ndryshme : Kryetari i ushtron funksionet e zakonshme të shefit të shtetit kurse Qeveria funksionet efektive të pushtetit shtetëror, sepse Kushtetuta shprehimisht e thekson vetëm Qeverinë si bartëse e këtij pushteti. Kryetari i Republikës e cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, por jo edhe përbërjen e saj, me ç'rast Kryetari nuk është plotësisht i lirë se cilit do t'ia besojë këtë mandate sepse Kushtetuta e obligon që mandatin për formimin e Qeverisë t'ia besojë kandidatit të partisë, përkatësisht të partive që kanë shumicën në Kuvend. Mandatari mundet, por nuk duhet ta konsultojë Kryetarin e Republikës lidhur me përbërjen e Qeverisë që do të thotë se ai është plotësisht i lirë në caktimin e përbërjes së Qeverisë sepse ajo përgjigjet para Kuvendit dhe jo para Kryetarit.⁸⁴ Kryetari i Republikës së Maqedonisë, i zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta, nuk i përgjigjet Kuvendit për punën e tij. Ai poasht, nuk ka iniciativë ligjvënëse as të drejta ta shpërndaj Kuvendin. Si i barabartë me Kuvendin për nga mënyra e zgjedhjes, ai e njofton atë për çështje nga kompetenca e tij së paku një herë në vit, ndërsa Kuvendi mund të kërkoj nga ai mendim për çështje nga kompetencat e tij. Kryetari i Republikës i shpall me dekret ligjet e miratuara nga Kuvendi. Dekretin e nënshkruan së bashku me Kryetarin e Kuvendit. Në rast se Kryetari i Republikës refuzon të dekretoj ligjin, Kuvendi e rishqyrton ligjin dhe në rast se

⁸⁴ Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" "Furkan ISM", Shkup, 2015, fq, 362.

e miraton atë me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, atëherë e detyron që Kryetari i Republikës ta bëjë dekretimin e tij. Por për dallim nga raporti me Kuvendin, raporti i Kryetarit të Republikës me Qeverinë është paksa më i ndërlikuar, kjo buron nga fakti se krahas Qeverisë edhe Kryetari i Republikës merr pjesë në uhstrimin e disa kompetencave ekzekutive. Sipas Kushtetutës, Qeveria është bartëse e pushtetit ekzekutiv, mirëpo poashtu sipas Kushtetutës edhe Kryetari i Republikës ka kompetenca që ndërlidhen me funksionet e tij standard, si : në lëmin e politikës së jashtme, në lëmin e mbrotjes dhe atë të sigurisë së vendit.⁸⁵ Kohabitimi që nga pavarësia e RM-së e deri më sot, ka manifestuar edhe përparësi (vendosja e ‘kontrollit dhe baraspeshimit’ brenda pushtetit ekzekutiv) edhe mangësi (rreziku potencial i jostabilitetit dhe joefikasitetit të këtij pushteti nëse nuk arrihet konsensusi midis bartësve të tij), sidomos : shfrytëzimin i vetos së Kryetarit ndaj ligjeve si një instrument i ndaljes së shumicës parlamentare dhe Qeverisë ; Qeveria nuk arrin të partizojë dipolomacinë me ‘ushtar partiak’ sepse ambasadorët i emëron Kryetari me propozim të Qeverisë ; në lëmin e politikës së jashtme gjatë kohë RM-ja nuk kishte ambasadorë në një numër të madh të vendeve të botës ; Kryetari mund të ndihmoj opozitën kundër qeverisë, etj.⁸⁶

⁸⁵ Mersim Maksuti, “E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë” Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq, 194 – 195.

⁸⁶ Jeton Shasivari “E drejta kushtetuese” “Furkan ISM”, Shkup, 2015, fq, 365.

6.1 Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Periodha e tranzicionit dhe sidomos proceset kushtetutdhënëse u përcollën me një dilemë të hapsur se çfarë Presidenti i duhej Shqipërisë. Një president i fortë me fuqi presidenciale, ose një President parlamentar i zgjedhur dhe i kontrolluar nga parlamenti. Këtë pyetje mund ta deshifrojmë edhe me dilemën tjetër një President partiak, ose një president neutral me funksione balancuese në raport me politikën. Këto dilema ishin aktuale edhe në dështimin e referendumit të vitit 1994, e cila pra parashikonte një President të fuqishëm, fakt ky që vlerësohej se ishte me ndikim në refuzimin e kushtetutës.⁸⁷ Në një vlerësim të përgjithshëm për pozitën që Presidenti merr në sistemin tonë kushtetues, do të konsistonte pra në radhë të pare si një organ neutral. Ai merr rolin e arbitrit të krizave institucionale, nuk zhvillon asnjë funksion aktiv në përcaktimin dhe drejtimin politik të vendit dhe është menjëherë në maksimum nga kompetencat ekzekutive. Pikërisht në këtë aspekt Presidenti i Republikës është : *“Kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”* (N.86/1), pra ai është *symbol i unitetit kombëtar*. Në personin e tillë përmbledhet dhe harmonizohet uniteti i shtetit, Kryetar i të cilit është ai. Ky pozicion i ri pajtohet më mirë me natyrën e republikës parlamentare dhe garanton zgjidhje më të kënaqshme të ndarjes midis pushteteve. Kushtetuta i rezervon atij vendin që tashmë kanë zënë mjaftë president të regjimeve parlamentare, duke e bërë atë një person të paanshëm e të pavarur.⁸⁸ Kushtetuta e RSH-së, ka parashikuar një kryetar shteti jo qeverisës , tipike kjo për një republikë parlamentare. Në një regjim të tillë, pozicioni i Presidentit përball organeve të pushteteve të ndryshme paraqitet jo

⁸⁷ Arsim Bajrami, “Demokracia Parlamentare” (botimi i katërtë), “Flaka”, Prishtinë, 2005, fq. 284-285.

⁸⁸ Aurela Anastasi “E drejta kushtetuese” Pegi, Tiranë, 2003, fq. 183

rrallë problematik. Kjo është arsyeja që nga dikush Presidenti konsiderohet si pushtet i katërt, por që është e pasaktë, sepse kushtetuta nuk njeh pushtet të katërt. *Presidenti si një organ sui generis, nuk qeveris dhe nuk administron, ai qëndron mbi të gjitha pushtetet, por nuk bën pjesë në to.* Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, ka element të tre pushteteve : legjislativ, ekzekutiv, e gjyqësor. Për këtë arsye ai ka kompetencë të nxjerrë akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administrates shtetërore.⁸⁹ Gjatë ushtrimit të tij, Presidenti i Republikës mbikqyr funksionimin e mekanizmit kushtetues dhe mund të ndërhyj brenda caqeve që i'a lejon Kushtetuta, kur konstaton që çënohen rregullat që e disiplinojnë këtë mekanizëm, për të siguruar respektimin , në formë e në përmbajtje, të Kushtetutës dhe rruajtjen e një ekuilibrimi të drejtë ndërmjet organeve të ndryshme shtetërore. Natyrisht shkalla e kësaj ndërhyrje varet edhe nga Personaliteti i Presidentit, nga mënyra se si ai e interpreton dhe e koncepton rolin e tij. Duke bërë një krahasim, qoftë edhe jot ë thelluar, midis presidentit të Republikës së Shqipërisë në periudhën 1997 – 2002 dhe Presidentit në periudhën 2002 – 2007, mund të thuhet se Presidenti i parë ka qenë më i rezervuar në ndërhyrjet e tij, ndërsa Presidenti i dytë ka qenë më i prirur për një gjë të tillë, por gjithmone brenda kuadratit të kompetencave të tij kushtetuese.⁹⁰ Vlejnë të konsiderohen edhe dy pamjet e ndërtimit të institucionit të Presidentit :

1. Politikisht i përfshirë dhe aktiv : Në këtë rast pra Presidenti mund të veprojë në mënyrë shumë më të vendosur, duke shërbyer edhe si kontrollues i pushteteve të kryeministrit. Aq më tepër kur Presidenti mbart edhe një ‘back – ground’ të konsiderueshëm partiak. Kjo bëhet akoma më problematike në kushte përplasjeje. Pra, në raste të tilla, konflikti midis dy institucioneve bëhet fatal për funksionimin normal të shtetit. Poashtu një problem tjetër për një president politikisht aktiv është edhe ‘rezistenca’ e tij ligjore, sidomos lidhur me procesin e vështirë kushtetues të shkarkimit të tij, pra ndryshe nga shkarkimi i kryeministrit që ka prerogative politiko – funksionale.

⁸⁹ Valbona Bala (Pajo), “Rrugëtim kushtetues : sfidat, arritjet, perspektiva e Gjykatës Kushtetuese”, ARTIC, Tiranë, 2018, fq. 278.

⁹⁰ Luan Omari, Aurela Anastasi, Dajti 2000, Tiranë, 2017, fq, 275

2. Politikisht jo aktiv dhe më tepër honoforik : Presidenti si simbol i unitetit ku nuk ka përfshirje të mirëfillt politike, duke shërbyer kështu si një guardian kushtetues dhe arbiter moral i institucioneve të shtetit, një mishërim i sovranitetit të popullit.⁹¹

6.2 Presidenti i Shqipërisë në politikbërjen e jashtme

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Shqipëria proklamohet si republik parlamentare dhe konform kësaj Presidenti votohet nga parlamenti. Por me fjalë të tjera, si për zgjedhjen e tij në këtë post, ashtu edhe me kompetencat e pakta kushtetuese që i ka, si dhe nga ushtrimi i vështirësuar në praktik, politika e jashtme mbetet jo në duart e tij por të Qeverisë. Nga gjithësej 12 kompetenca kushtetuese, Presidenti i Republikës së Shqipërisë i ushtron vetëm tre kompetenca në politikën e jashtme edhe atë :

⁹¹ Rexhep Meidani, "Mbi qeverisjen" (pjesa e parë), Dudaj, Tiranë, 2009, fq, 187

1. Emërimin dhe lirimin e përfaqësuesëve diplomatik të Shqipërisë – por me propozimin e kryeministrit;

2. Pranimin e letrave kredenciale të përfaqësuesëve të huaj diplomatik në Shqipëri;

3 Lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare sipas ligjit.

Këto zgjedhje kushtetuese në periudhën dhjetë vjeçare 1998 – 2008, nuk i japin Presidentit së Shqipërisë ndonjë rol dhe peshë të veçantë në politikën e jashtme , por më tepër krijun një president ceremonial dhe formal.⁹² Në fillimin e qeverisjes Berisha, dukej qartë se politika e jashtme e Shqipërisë anonte më së shumti nga Shtetet e Bashkuara, të cilët kishin mbështetur shumë demokratizimin e saj. Në fillimin e viteve 1990, ndoshta nuk gjeje ndonjë vend tjetër në Europë në të cilën kishte aq simpati për Shtetet e Bashkuara se sa në Shqipëri. Kjo u duk në qershor të vitit 1991, gjatë një vizite të sekretarit të shtetit të Shteteve të Bashkuara James A, Baker. Gjatë viteve 1991 dhe 1992, ambasadori amerikan William Ryerson dhe zëvendës kryetari i misionit Christopher Hill, luajtën një rol vendimtar në inkurajimin e procesit të demokratizimit të Shqipërisë, duke ushtruar poashtu presion të ndjeshëm ndaj komunistëve që procesi i tranzicionit të zhvillohej në mënyrë paqësore dhe poashtu pa pengesa. Me të marrë pushtetin, demokratët bënë çmos për të vendosur lidhje të forta me Shtetet e Bashkuara. Ndër udhëtimet e para të Berishës si president ishte vizita që ai i bëri Shtëpisë së Bardhë në qershorin e vitit 1992 për të biseduar me presidentin Bush. Qëllimi i vizitës së Berishës ishte që të siguronte një mbështetje nga Shtetet e Bashkuara për zbatimin e reformave rrënjësore politike dhe ekonomike dhe për të parandaluar shpërthimin e luftës në Kosovë.⁹³ Ndërsa për Tiranën, Maqedonia ku jetonin një bashkësi e madhe shqiptarësh ishte një burim ankthi i vazhdueshëm dhe një parandjenjë se destabilizimi i këtij shteti të porsalindur mund të ishte shkak për ndërhyrjen e Sërbisë dhe si rezultat, për rrethimin serbo – grek të Shqipërisë. Presidenti Berisha mbështeste fuqishëm Maqedoninë, duke theksuar se një shtet i pavarur që ndan Sërbinë armike nga Greqia është në interes kombëtare dhe jetësore të Shqipërisë. Duke theksuar pajtimin e interesave politike dhe ekonomike të të dy vende, për të kundërbalancuar aleancën e ngushtë midis Sërbisë dhe Greqisë, Berisha bënte përpjekje të vendoste lidhje të ngushta me

⁹² Blerim Reka "Presidenti dhe politika e jashtme – një shqyrtim komparativ" revista CONSTITUTIO - 1/2012, fq, 102-103.

⁹³ Elez Biberaj "Shqipëria në tranzicion : rruga e vështirë drejt demokracisë 1990 – 2010 "Instituti i studimeve ndërkombëtare " Tiranë, 2011, fq, 316.

Maqedoninë. Në prill 1993, Shqipëria qe ndër vendet e para që njohu Maqedoninë, dhe duke ngrëne kështu kritika të forta brenda vendit dhe duke marrë një përgjigje të ashpër nga Athina. Ky vendim ishte në përputhje me politikën e Berishës që kishte si synim të mos inkurajonte prirjet seperatiste të shqiptarëve me shpresën që në këtë mënyrë do të forconte qëndrueshmërinë e Maqedonisë.⁹⁴

6.3 Roli i Presidentit të Shqipërisë në luftën e Kosovës

Kur u zgjodh Mediani President, Kosova po harxhonte ditët e fundit të një rezistence të gjatë paqësore. Nga të gjitha qendrat e politikës botërore po paralajmërohej shpërthimi i saj. Në këto kushte nuk dukej se ishte gjeniale të parashikohej se mandati i porsafilluar i presidentit, do të mbulohej para së gjithash, nga problemi i Kosovës. Në axhendën e shtetit shqiptar, normalizimi, zhvillimi dhe integrimi ishin synimet themelore. Çdo hap përpara në këto pista do të kishte një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përmirësimin e jetës së shqiptarëve. Por, logjikisht rruga e gjatë dhe do të lidhte disa mandate politike. Por në të vërtetë, normalizimi real i Shqipërisë do të vinte nëpërmjet çlirimit të Kosovës dhe jo anasjelltas, siç gjykohej rëndom në Shqipëri. Presidenti Meidani i ka dhënë një vend parësor çështjes së Kosovës në tërë veprimtarinë e tij politiko –

⁹⁴ Po aty, fq, 328 – 329.

diplomatike. Ai kishte idet e tij dhe etapat dhe faktorët e zgjidhjes së këtij problemi.⁹⁵ Në javën e fundit të prillit, ndërkohë që lufta në Kosovë ishte intensifikuar me shpejtësi në Kosovën veriperëndimore, ambasada Greke ushtroi një presion të madh mbi Nanon për të shkarkuar ministren e Kulturës, Arta Dade dhe ministrin e Mbrojtjes Sabit Brokaj, të dy këto atdhetar të devotshëm brenda Partisë Socialiste, pasi këto nuk kishin zbatuar udhëzimet e ambasadës greke për çështjen e politikës së Kosovës. Athina kërkonte një politikë të arrestime masive të ushtarëve të UÇK-së, që vepronin prej tokës shqiptare. Nano u bind, por Presidenti Rexhep Meidani refuzoi të firmoste urdhërin për shkarkimin e ministrave, duke krijuar kështu një konflikt të hapur midis Presidentit dhe Kryeministrit, i cili ziente që kur Meidani ishte zgjedhur President. Sipas Kushtetutës, Presidenti Meidani ishte komandant i forcave të armatosura dhe si i tillë nuk mund të duronte presionet e Athinës mbi qeverinë e Tiranës për të bashkëpunuar me serbët kundër UÇK-së.⁹⁶ Roli dhe pozita e Presidentit Meidani vazhdonin të përmirësoheshin tashmë që Nano nuk ishte më Kryeministër. Meidani u bë një figure që gëzonte respekt të madh në bashkësinë ndërkombëtare me thjeshtësinë dhe natyrën gazmore, me një mënyrë modeste të jetesës dhe me ndjeshmërinë e tij atdhetare. Me thellimin e krizës Meidani ishte në gjendje të shfaqte rolin e tij si një President i gjithë shqiptarëve, sikurse e parashikonte edhe kushtetuta, si dhe të artikulonte edhe intereset e çështjes kombëtare, të cilët Berisha tepër rrallë kishte arritur ta bënte me qartësi. Në këtë mënyrë ai dha një ndihmesë të rëndësishme për stabilizimin e krizës së Kosovës dhe për parandalimin e shfrytëzimit të saj për qëllime partiake.⁹⁷

⁹⁵ Preç Zogaj, "Intuicionet e tranzicionit 1" UET Press, Tiranë, 2009, fq, 481

⁹⁶ James Pettifer, Miranda Vickers, "Çështja shqiptare, riformësimi i ballkanit", Bota Shqiptare, 2007, Tiranë, fq, 187 – 188.

⁹⁷ James Pettifer, Miranda Vickers, "Çështja shqiptare: Riformësimi i Ballkanit" Bota Shqiptare, 2007, fq, 294

7.1 Roli i Presidentit të Republikës së Kosovës

Njëra nga çështjet më të diskutuara në kuadër të doktrinës së ndarjeve të pushteteve është edhe përcaktimi i rolit që ka presidenti në kuadër të ndarjes së balancimit të pushteteve në republikat parlamentare çfarë është edhe Kosova. Studiuesit gjenden në vështirësi për të dhënë një përcaktim nëse presidenti bën pjesë në një nga tri degët kryesore të pushtetit apo paraqet një pushtet të katërt. Në fakt presidenti në raport me organet tjera të pushtetit shtetëror konsiderohet si organi më i lartë dhe që gëzon një pavarësi më të gjërë veprimi se organet tjera, kjo pavarësi në një mënyrë gjen mishërim te pozicioni i tij si përfaqësues i unitetit të popullit. Prej me mbarimin e luftës në vitin 1999 e tutje në Kosovë ka pasur dilema, nëse Kosova do të duhej të kishte një president të zgjedhur drejtpërdrejt nga ana e popullit apo një president që do të zgjidhej nga parlamenti. Në diskutime për hartimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë gjatë vitit 2001 kishte mendime të ndryshme por në fund u vendos për modelin e presidentit të zgjedhur nga Kuvendi. Por edhe me Kushtetutën e vitit 2008 u zgjodh ky model.⁹⁸ Por pas një cikli sfidash në funksionimin e institucionit të presidentit të shtetit të cilat filluan me aktgjykimin e gjykatës kushtetuese i cili shpalli Presidentit Sejdiu si president që ka shkelur kushtetutën duke e mbajtur të ngrir edhe postin e LDK-së, por edhe pas dështimit për të zgjedhur Pacolli në rrugën ligjore, apo pas zgjedhjes jo të rregullt të Pacollit nga ana e kuvendit – kuvendi i Republikës së Kosovës ka parë të rrugës të filloj një reformë sa i përket çështjes së zgjedhjes së presidentit duke mundësuar fillimin e amandamentimit kushtetues në përgaditjen e infrastrukturës ligjore për të realizuar zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit. Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur me 22.04.2011, ka formuar Komisionin parlamentar për përgaditjen e amandamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 83 përcakton se Presidenti është kreu i shtetit si dhe

⁹⁸ Përparim Gruda, "Ndarja e Pushteteve", "Juridica", Prishtinë, 2015, fq, 43-44

⁹⁹ Arsim Bajrami, "Sistemi kushtetues i republikës së Kosovës", "AAB", Prishtinë, 2014, fq, 286

përfaqësues i unitetit të popullit. Shumë kushtetuta të vendeve demokratike i kanë dhënë Presidentit atributin e të qenit përfaqësues i unitetit të popullit dhe kombit, duke i dhënë Presidentit një mundësi që të qeverisë me vendin në mënyrë neutrale.¹⁰⁰ Në kuptim të interpretimit të Kushtetutës së Kosovës uniteti i popullit si atribut i veçantë i Presidentit pra si kreu i shtetit është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në disa raste. Në rastin nr. KI47/10 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës uniteti i popullit trajtohet në prizmin e asaj që një President nuk mund të mbajë funksione në parti politike. Mbajtja e postit në një parti politike, sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ‘lëndon’ unitetin e popullit, pasi që të qenit pjese e një partie politike Presidenti do ta vendoste në një pozicion të njëanshëm kushtetues përball unitetit të popullit në përgjithësi dhe të unitetit politik në veçanti. Ndër të tjera, në lidhje me çështjen e unitetit të popullit Gjykata Kushtetuese e Kosovës në rastin KI47/10 konstaton : *‘Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna në bazë të Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të presupozojë se Presidenti i tyre, që ‘përfaqëson unitetin e popullit’ dhe jo një fragment ose interes politik partiak, do të përfaqësoj të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit. Kjo për më tepër, kur ai ushtron zgjedhje politike, si kur zgjedh kandidat konkurrent nga koalicionet të mundshme për tu zgjedhur Kryeministër’*. Në bazë të këtij rasti, një ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësoj vetë Presidenti për të qenë përfaqësues i unitetit të popullit është që të mos mbajë ndonjë pozitë në parti politike, qoftë kjo edhe pozitën e një anëtari të thjeshtë. Ky është një standard kushtetues tashmë i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.¹⁰¹

¹⁰⁰ Arsim Bajrami, Florent Muçaj, “E drejta kushtetuese”, “Universiteti Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2018, fq, 382 – 383.

¹⁰¹ Po aty, fq, 383 - 384

7.2 Presidenti i shtetit në sferën e politikës së jashtme

E drejta e Presidentit për të nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare është një kompetencë e tij e cila lidhet me rolin që ka Presidenti në politikën e jashtme. Kjo kompetencë i është dhënë edhe shumë presidentëve sipas kushtetutave. Kështu një rol aktiv në politikën e jashtme, si dhe ratifikimin e traktateve ndërkombëtare e ka Presidenti Francez. Por përveç këtyre rasteve siç e përmendëm, në shumicën e sistemeve kushtetuese Presidenti ka tagrin kushtetues për të qenë nënshkruar i marrëveshjeve ndërkombëtare. Një rol të ngjashëm hasim edhe në Kushtetutën e Bosnjes dhe Hercegovinës, ku Presidenti kolegjal ka kompetencë t'i negociojë dhe nënshkruajë traktatet ndërkombëtare. Njëjtë edhe Presidenti i Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar në lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke qenë sipas Kushtetutës edhe si udhëheqës i politikës së jashtme. Presidenti i Republikës së Kosovës mund t'i nënshkruaj edhe marrëveshjet ndërkombëtare që kërkojnë ratifikimin në Kuvend , sipas nenit 18.1 të Kushtetutës së Kosovës. Të tjerat përpos që ka kompetencë t'i nënshkruaj është edhe autoritet përfundimtar të hyrjes në fuqi të tyre. Kështu të gjitha marrëveshjet e tjera, në përjashtim të atyre që ratifikohen në votim në Kuvend, konsiderohen të (hyjnë në fuqi) pas nënshkrimit nga ana e Presidentit të Kosovës ¹⁰² Vështruar problemin në këtë linjë, mund të theksojmë se Kushtetuta e Kosovës njih dy lloj marrëveshjeve ndërkombëtare :

- Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen pas votimit në Kuvend ;

¹⁰² Arsim Bajrami, Florent Muçaj, "E drejta kushtetuese", "Universiteti Hasan Prishtina", Prishtinë, 2018, fq,391

- Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen pas nënshkrimit .

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 18 ka përcaktuar në mënyrë taksative marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen pas votimit në kuvend. Ky votim nënkupton 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës . Në këtë kategori të marrëveshjeve hyjnë marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen më këto çështje :

- Territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- Të drejtat dhe liritë themelore;
- Antarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare;
- Marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

Marrëveshjet e lartëcekura ratifikohen me ligj, i cili duhet që të përmbaj edhe tekstin e marrëveshjeve ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit, deklaratën financiare dhe implikimet buxhetore nëse ka të tilla. Duke marrë parasysh kategorizimin e marrëveshjeve të cilat për ratifikim duhet të votohen me 2/3 e të gjithë deputetëve të kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo nënkupton që të gjitha marrëveshjet e tjera ratifikohen pas nënshkrimit të tyre, pa pasur nevojë që ato të votohen në kuvend. Por çështja e rëndësishme është se kush duhet t'i nënshkruaj marrëveshjet ndërkombëtare? Kushtetuta e ka përcaktuar që marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen me nënshkrim, konsiderohen si të tilla pas nënshkrimit të presidentit të Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë presidenti i Republikës së Kosovës nënkupton autoritetin i cili mund t'i nënshkruaj marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës, kjo përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁰³ Në praktikën kushtetuese të Kosovës presidentët në detyrë që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës në vitin 2008 kanë ratifikuar një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare, duke u bazuar në këtë kompetencë të Presidentit si dhe nenin 18.2 të Kushtetutës. Kështu për shembull ish – Presidentja Jahjaga në vitin 2016 bazuar në këtë kompetencë ratifikoi marrëveshjen me shtetin e Holandës ‘‘Për organizimin e institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i zhvendosur në Holandë’’. Gjithashtu në prill të vitit 2015 bazuar në këtë kompetencë të saj ish – Presidentja Jahjaga nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe të

¹⁰³ Arsim Bajrami ‘‘Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës’’, ‘‘Kolegji AAB’’, Prishtinë, 2014, fq, 178

Emirateve të Bashkuara Arabe. Kjo kompetencë po ashtu në shumë raste ishte shfrytëzuar edhe nga ish – Presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu, siç është pra shembulli i dekretimit të marrëveshjes ndërkombëtare për bashkëpunim në fushën e mjedisit në mes të qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Turqisë, të 7 qershorit 2010. Sipas evidencave zyrtare, deri tani presidentët në detyrë të Republikës së Kosovës, nga viti 2008- 2016, duke shfrytëzuar këtë kompetencë kanë nënshkruar 226 marrëveshje ndërkombëtare.¹⁰⁴

¹⁰⁴ Arsim Bajrami, Florent Muçaj, “E drejta kushtetuese” “Universiteti Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2018, fq, 391 - 392

7.3 Roli i Presidentit Ibrahim Rugova në procesin e politikbërjes

Që nga fillimi i vitit 1992 Sërbia kishte krijuar në Kosovë një sistem apartheidi dhe kontaktet midis dy grupeve etnike ishin prishur pothuajse krejtësisht. Në kushtet e pushtimit ushtarak dhe policor, shqiptarët organizuan zgjedhjet e para shumë partiake në Kosovë, më 24 maj, 1992. Rugova që ishte që ishte edhe kandidati i vetëm u zgjodh President i Republikës së Kosovës.¹⁰⁵ Zgjedhjet ishin zhvilluar në kushtet e terrorit e dhunës serbe. Policia dhe strukturat e tjera të sigurimit serb në Kosovë kishin bërë presione të shumta dhe kishin paralajmëruar se do të reagonin me dhunë kundër këtij procesi. Megjithatë më 24 maj 1992 populli i Kosovës i kishte dhënë vendit parlamentin si dhe Presidentin e ri. Madje me një pjesëmarrje masive në votime dhe me shumicë të admirueshme për Lidhjen Demokratike të Kosovës. Vetë Ibrahim Rugova kishte marrë mbi 98 për qind të votave për të marrë postin e Presidentit.¹⁰⁶ Menjëherë pas veprimtarisë së tij politike në Kosovë, Ibrahim Rugova kishte specifikuar si qëllimin e tij kryesor organizimin e lëvizjes çlirimtare, me synimin e vetëm lirinë e Kosovës nga pushtimi kolonialist serb. Por lëvizja e shqiptarëve do të kishte një vizion të ri, një refleksion të ri, një pamje të re, krejt ndryshe nga ajo çfarë kishte ndodhur në lëvizjen mbi njëshekullore të shqiptarëve për çlirim nacional e liri shoqërore. Madje vetë vizioni i Ibrahim Rugovës nuk ishte shfaqur ndonjëherë në historinë e vendeve të Ballkanit. Ai ishte një lloj lëvizje që synonte detyrimin moral, bazuar në vlera. Ajo ishte një lëvizje për çlirim bazuar në virtytet, në moralin e shoqërisë njerëzore, për pasojë efektet e saj ishin befasuese, të pallogaritshme. Thelbi i lëvizjes së Rugovës për çlirim ishte mos – përdorimi i dhunës. Kjo nga pikpamja e revolucionare dhe veçmas ajo marksiste, dukej paradoksale që çlirimi prej pushtimit dhe kolonizimit të realizohet përmes një rezistence paqësore e jo të dhunshme. Këtu qëndronte edhe vizioni i Rugovës, ai së paku në Ballkanin e trazuar dhe të njohur si “fuqi baroti”, solli koncepte, ide, të cilat ishin mbartur me konotacione

¹⁰⁵ Elez Biberaj “Shqipëria dhe shqiptarët në udhën e rimekëmbjes”, AiiS, Tiranë, 2014, fq, 200 – 201.

¹⁰⁶ Enver Bytyçi, “Filozofia politike dhe nacionale e Ibrahim Rugovës” (botimi i dytë), Instituti i studimeve të Europës Juglindore, Tiranë, 2011, fq, 127.

negative për shumë shekuj.¹⁰⁷ Ibrahim Rugova kishte gjetur kështu çelësin e zgjidhjes. Ai kishte formuluar politikën e tij të mbështetur në dy shtylla: Njohjen e së vërtetës dhe përhapjen e saj nga njëra anë si dhe realizimin e secesionit, shkëputjes de facto nga sudimi policor e ushtarak serb. Të dy këto rrugë do të duhej të çonin në të njëjtin shteg, në të njëjtin qëllim : Çlirimin e vendit dhe realizimin e shtetit të pavarur. Kjo strategji, e cila Gandhit i kishte dhënë rezultatet e njohura në Indi, duhej të jepte rezultate edhe në Kosovë. Në Indi lëvizja kishte filluar me refuzimin dhe kritikën e ligjeve dhunuese të kolonizatorëve anglezë. Në Kosovë Rugova edhe bashkpuntorët e tij e kishin filluar këtë luftë pikërisht me kundërshtimin e vendosur të ligjeve të aparteidit të shtetit serb. Kjo luftë midis dy mënyrave të kundërta të konceptuarit dhe perceptuarit e ligjeve, tërhiqte më mirë vëmendjen e vëzhguesve si dhe autoriteteve ndërkombëtare qeveritare e jo qeveritare për gjendjen në Kosovë. Një kombinim i denoncimit të dhunës serbe, nga aspekti i ruajtjes së të drejtave të njeriut e deri te aspekti i kërcënimit të qenies nacionale ishte rruga më e përshtatshme e sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar.¹⁰⁸ Duke e njohur epërsinë e fuqisë që gëzonte Serbia në lidhje me Kosovën, Rugova u bëri thirrje shqiptarëve të ndiqnin objektivat e tyre me anën e metodave jo të dhushme. Pavarësisht nga kontrolli serb, lëvizja e Rugovës u pajis me një sërë atributesh të shtetit. Përmes Fondit të Solidaritetit, që financohej nga brenda vendit, ashtu edhe nga diaspora e madhe shqiptare në Europën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara, u krijua një sistem i vaçantë arsimor që nga shkolla fillore deri te Universiteti, si dhe shërbimi shëndetësor. Poashtu Kosova njohu edhe zhvillimin e një shoqërie civile mbreslënëse.¹⁰⁹ Por udhëheqjen e vetë Rugova nuk e pa asnjëher më të rrezikuar kur Rugova u ndesh me sfidën më të madhe të udhëheqjes së tij në nëntor 1996, kur në Beograd shpërthyen demonstratat për demokracinë. Rugova reagoi duke theksuar se nuk ekzistonte ndonjë ndryshim midis Millosheviqit dhe udhëheqësve të opozitës serbe dhe protestat e Beogradit janë çështje e brendshme e serbisë. Kundërshtarët e Rugovës e dënuan qëndrimin e tij pasiv dhe bënë thirrje për protesta dhe demonstrata paqësore. Ndërkaq, qeveria e Tiranës mbështeti publikisht koalicionin e opozitës serbe dhe, duke bërë një hap të pazakont, u bëri thirrje shqiptarëve të Kosovës që të bënin edhe ata protesta paqësore.¹¹⁰ Rugova e kishte të qartë se se kauza e shkëputjes së Kosovës nga Serbia do të kërkonte fli dhe sakrifica të mëdha. Ai

¹⁰⁷ Po aty, fq, 78-79

¹⁰⁸ Po aty, fq, 83

¹⁰⁹ Elez Biberaj "Shqipëria dhe shqiptarët në udhën e rimëkëmbjes" Aiiis, Tiranë, 2014, fq, 296.

¹¹⁰ Elez Biberaj "Shqipëria në tranzicion : rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010" Aiiis, Tiranë, 2011, fq 354

mëtonte shtyrjen në kohë të përplasjes së madhe me Sërbinë, duke llogaritur izolimin dhe vjetrimin e Jugosllavisë së mbetur si dhe ndryshime të tjera të favorshme në planin ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, çmimin që do ta paguante vetë Kosova do të ishte më i lire. Kjo strategji kishte shumë mbështetës. Njerëzit nga natyra duan të jetojnë , kur kanë përpara dy – tri rrugë që i çojnë drejtë së njejtës ëndërr, shumica zgjedh rrugën ma të pa rrezikshme edhe pse mund të jetë më e gjatë. Pa mohuar vlerat e personaliteti të tij, si një intelektual i spikatur i elitës kosovare, autoriteti politik i Rugovës bazohej para se gjithash në zgjedhjen e shumicës, në një far mënyre ai diktohej në politik nga fara e ideve që kishte hedhur vetë. Por çdo ide sado që të jetë e bazuar, fillon të artificializohet kur nuk jep fryte, kështu me kalimin e kohës dukej se lëvizja pacifiste e Rugovës dukej se hyri në rutinë, u burokratizua, u përshtat me rrethanat dhe humbi fillin e një perspektive, duke provokuar kështu zgjimin e një lëvizje alternative, që bënte thirrje për rezistencë aktive, deri me armë kundër pushtuesit serb.